



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2020:016657

Datë: 27.06.2023

Numri i dokumentit: 04614912

**PS.nr.10/20**

## **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – DEPARTAMENTI SPECIAL**, trupi gjykues i përbërë nga gjyqtarët: Mentor Bajraktari – kryetar i trupit gjykues, Kujtim Krasniqi dhe Lutfi Shala – anëtar të trupit gjykues, me procesmbajtësen Mirjetë Demiri – zyrtare ligjore pranë kësaj gjykate, në lëndën penale ndaj të akuzuarit S B nga Peja, për shkak të veprës penale marrja e ryshfetit nga neni 421 par.2 lidhur me par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës<sup>1</sup> dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Speciale e Republikës së Kosovës<sup>2</sup>, me numër PPS.nr.52/19, të datës 05.02.2020, pas mbajtjes së seancave të shqyrtimit gjyqësor, në prezencën e Prokurorit të shtetit nga PSRK – Ilir Morina, të akuzuarit si dhe mbrojtësve të tij sipas autorizimit avokatëve Besnik Berisha nga Prishtina dhe Veton Berisha nga Peja, **me datën 28.04.2023** mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datën 27.06.2023 e përpiloi këtë:

## **A K T G J Y K I M**

### **I akuzuari:**

**S B**, nga i ati ..., e ëma ..., e gjinisë ..., i lindur me datën ..., në fshatin ... Komuna Pejë, tani me vendbanim në Pejë, në rrugën "...", ..., i martuar, baba i gjashtë (6) fëmijëve, me profesion jurist, ...në Gjykatën Themelore në Pejë, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar – shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal:...

## **Ë S H T Ë F A J T O R**

<sup>1</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës (Në tekstin e mëtejme KPRK-së), nr.06/L-074, i datës 14.01.2019, i cili ka hyrë në fuqi më 19.04.2019.

<sup>2</sup> Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, (Në tekstin e mëtejme PSRK-së)

**I.** Sepse me datën 19 shtator 2019 në Pejë, si person zyrtar, .... në Gjykatën Themelore në Pejë – Departamenti për Krime të Rënda, në mënyrë të drejtpërdrejtë ka pranuar dhuratën për vete dhe për personin tjetër të ashtuquajtur “daja”, në atë mënyrë që ditën kritike i akuzuari kishte lënë takim me dëshmitarin F Z dhe pas përfundimit të orarit të punës me të njëjtin janë takuar për drekë në restorant “Toni” në Pejë, për shkak se dëshmitari ia kishte sjellë të akuzuarit si dhuratë paratë në vlerë prej dymijë (2000) Euro, për të cilën shumë ishin dekoduar me dëshmitarin me herët (në kohën e procedimit të çështjes) që pas përfundimit të rastit ku si i akuzuar ishte vëllai i dëshmitarit F Z, ndërsa si kryetar i trupit gjykues ishte i akuzuari S B, ashtu që i njëjti të veprojë në pajtim me detyrën e tij zyrtare (ta marr një vendim më të favorshëm për vëllain e dëshmitarit), me ç’rast edhe e kishte marrë Aktgjykim me numër PRKP.nr..., të datës 05.01.2016, për dy veprat penale të kontrabandimit me migrantë nga neni 138 të KPRK-së për të cilat akuzohej i kishte shqiptuar dënim të kushtëzuar me burg prej tre (3) viteve, i cili dënim nuk do të ekzekutohej në afat prej dy (2) viteve, ashtu që i akuzuari ditën kritike pas përfundimit të drekës së bashku me dëshmitarin F dalin nga restoranti “Toni” dhe të njëjtit kanë shkuar tek vetura e dëshmitarit ashtu siç ishin darkorduar gjatë drekës dhe pasi që kanë hyrë brenda, i akuzuari ka pranuar nga dëshmitari shumë e parave në vlerë prej dymijë (2000) Euro dhe pasi del nga vetura e dëshmitarit duke shkuar në veturën e tij arrestohet nga Policia të cilët që nga fillimi i takimit të akuzuarin e kishin nën vëzhgim të masave të fshehta.

**Me këto veprime ka kryer veprën penale marrja ryshfetit nga neni 421 par.1 të KPRK-së.**

**II.** Sepse nga data e pacaktuar deri më datën 19.09.2019, në banesën e tij në Pejë, në rrugën “...” nr.4, në kundërshtim me ligjin mbi armët, në mënyrë të pa autorizuar ka mbajtur në posedimin armën dhe atë: një (1) revole të tipit “Zaza Mini” kalibrit 8 mm, me numër serik: T.592372, se bashku me 10 fishekë, e cila është gjetur dhe sekuestruar në banesën e tij në dhomën e gjumit me rastin e bastisjes që kishte ndërmarrë policia, e për të cilën armë i akuzuari nuk posedonte leje për posedim sipas ligjit mbi armët.

**Me këto veprime ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll, posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së.**

**Konform nenit 76 par.1 të KPRK-së, Gjykata të akuzuarit për veprat penale të lartpërmendura fillimisht ia shpallë vetëm dënimet me gjobë si në vijim:**

- Për veprën penale **marrja ryshfetit nga neni 421 par.1 të KPRK-së**, të përshkruar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, **ia shpallë dënimin me gjobë në shumë prej katërmijë (4000) Euro.**
- Për veprën penale mbajtja në pronësi kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, të përshkruar si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, **ia shpallë dënimin me gjobë në shumë prej njëmijë (1000) Euro.**

Andaj, gjykata në kuptim të neneve 4, 6, 7, 17 par.1, 38, 39, 40, 42, 43, 59, 62, 69, 70, 76 par.2 nënpar.2.4, 79 par.1 të KPRK-së, **nenit 421 par.1 dhe 366 par.1 dhe par.3 të KPRK-së**, si dhe neneve 113, 276 par.2 nënpar.2.1 dhe 364 të Kodit të Procedurës Penale<sup>3</sup>, të akuzuarin e:

## **G J Y K O N**

**ME DËNIM ME BURGIM** në kohëzgjatje prej dy (2) vite e gjashtë (6) muaj, në të cilin dënim do të llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 19.09.2019 deri me datën 13.12.2019, si dhe koha e kaluar në arrest shtëpiak nga data 14.12.2019 deri me datën 23.03.2020, dhe

**ME DËNIM UNIK ME GJOBË**, në shumë prej pesëmijë (5.000) Euro, të cilin dënim i akuzuari është i obliguar ta paguaj në afat prej një (1) muaji nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj dënimin unik me gjobë, atëherë të akuzuarit dënimi unik me gjobë i zëvendësohet me dënim me burgim në kohëzgjatje prej dyqindpesëdhjetë (250) ditëve, duke e llogaritur për çdo ditë të kaluar në burgim nga njëzet (20) Euro.

Konform nenit 59 par.1 dhe par.2 nënpar.2.3 dhe nenit 62 par.1 dhe nënpar.4.1 të KPRK-së, ndaj të akuzuarit i shqiptohet edhe:

## **D Ë N I M I P L O T Ë S U E S**

<sup>3</sup>Kodi i Procedurës Penal (Në tekstin e mëtejme KPP-së), nr.08/L-032, i datës 14.07.2022, i cili ka hyrë në fuqi më 18.04.2023.

**I NDALOHET USHTRIMI I FUNKSIONEVE NË ADMINISTRATËN PUBLIKE OSE NË SHËRBIMIN PUBLIK në kohëzgjatje prej tri (3) viteve, e cila ndalesë do fillojë të ekzekutohet pas mbajtjes së dënimit me burgim të shqiptuar me këtë aktgjykim.**

Ndaj të akuzuarit **KONFISKOHET** arma e tipit “Zaza Mini” e kalibrit 8 mm, me numër serik:T.592372, së bashku me 10 fishekë, si objekt i kryerjes së veprës penale.

**Të akuzuarit S B**, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi **I KTTHEHET shuma e mjeteve-parave** prej dhjetëmijë (10.000.00) Euro, për shkak se nuk ka bazë ligjore për konfiskimin e tyre përkatësisht nuk është vërtetuar se të njëjtat janë përfituar me vepër penale ashtu që **OBLIGOHET** Agjencia për Sekuestrimin e Pasurisë së Konfiskuar në Prishtinë që të njëjtat t`ia dorëzojë të akuzuarit shumën e parave të lartpërmendura të sekuestruara.

**DETYROHET** i akuzuari që ti paguajnë shpenzimet e paushallit gjyqësor në shumë prej treqind (300) Euro si dhe në emër të programit për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej njëqind (100) Euro, të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

## A r s y e t i m

### 1. Ecuria e procedurës penale

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, pranë kësaj gjykate me datën 05.02.2020 ka ngritur aktakuzën me numër PPS.nr.52/19, të datës 05.02.2020, ndaj të akuzuarit S B nga Peja, për shkak të veprës penale marrja e ryshfetit nga neni 421 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Pas ngritjes së aktakuzës është caktuar dhe mbajtur shqyrtimi fillestar, më datën 18.09.2020 në Departamentin e Special të Gjykatës Themelore në Prishtinë, në të cilën seancë i akuzuari S B, nuk e ka pranuar fajësinë për veprat penale për të cilat është ngarkuar me aktakuzë, me ç`rast kryetari trupit gjykues, i ka udhëzuar të akuzuarin dhe mbrojtësit e tij që deri në shqyrtimin e dytë dhe atë deri me datën 19.10.2020, ata duhet të parashetrojnë kundërshtimet përkitazi me

pranueshmerinë e provave në mbështetje të nenit 249 par.1 të KPP-së dhe kërkesat për hedhjen e aktakuzës në rast se ekzistojnë arsyet nga neni 250 par.1 të KPP-së.

Mbrojtësi i të akuzuarit S B Av.Besnik Berisha, me datën 16.10.2020, brenda afatit gjyqësor kishte parashtruar kundërshtim ndaj provave dhe kërkesë për hedhjen e aktakuzës. Ndërsa me datën 27.10.2020, Prokurori i shtetit nga PSRK Dren Paca, kishte parashtruar një parashtresë me të cilin kishte dhënë përgjigje në kundërshtimin ndaj provave dhe kërkesës së mbrojtësit për hedhjen e aktakuzës.

Shqyrtimi i dytë në këtë çështje penale ishte caktuar me datën 19.10.2020 dhe për arsye objektive ishte shtyrë dhe mbajtur me datën 04.11.2020, në të cilën seancë ishin të pranishëm prokurori i shtetit nga PSRK-ja – Dren Paca, i akuzuarit S B me mbrojtësit av.Gëzim Kollçaku dhe av.Veton Berisha që të dy nga Peja, që të dy sipas autorizimit.

Me aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti Special, me numër PS.nr.10/20, të datës 04.12.2020, ishin refuzuar kërkesa për hedhjen e aktakuzës dhe kundërshtimet ndaj provave të datës 16.10.2020 të ushtruar nga mbrojtësi i të akuzuarit S B, av.Besnik Berisha, mirëpo me aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN.S.nr.56/2020, të datës 09.02.2021, me aprovimin e ankesës së mbrojtësit të akuzuarit S B, e sipas detyrës zyrtare është anuluar aktvendimi i gjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti Special, PS.nr..., i datës 04.12.2020, dhe çështja penale është kthyer në rivendosje.

Në rivendosje Gjykata, me aktvendimin me numër PS.nr.10/20, të datës 04.06.2021, përsëri kishte refuzuar si të pabazuara kërkesën për hedhjen e aktakuzës dhe kundërshtimet ndaj provave, të parashtruara nga mbrojtësi e të akuzuarit S B av.Besnik Berisha, ashtu që kundër këtij aktvendimi mbrojtësi i të akuzuarit kishte parashtruar ankesë, mirëpo me aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës me numër PN.S.nr.35/21 të datës 27.07.2021, ishte refuzuar si të pabazuara ankesa e mbrojtësit av.Besnik Berisha dhe Aktvendimi Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti Special me numër PS.nr. 10/20 të datës 04.06.2021, me cilin ishin refuzuar si të pabazuara kërkesa për hedhjen e aktakuzës dhe kundërshtimet ndaj provave ishte vërtetuar.

Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti Special, në këtë çështje penale ka mbajtur shqyrtime gjyqësore<sup>4</sup>, ashtu që shqyrtimi gjyqësor ka filluar më datën 23.09.2021 dhe ka

---

<sup>4</sup> Të gjitha procesverbalet e seancave të shqyrtimit gjyqësor, duke u bazuar në nenin 311 par.1 të KPP-së, janë përpiluar me shkrim të cilat procesverbale gjenden në shkresa e lëndës ashtu që shqyrtimi gjyqësor nuk është

përfunduar me datën 24.04.2023. Gjatë seancave të shqyrtim gjyqësor kanë marrë pjesë përkatësisht akuzën e kanë përfaqur Prokurorët e shtetit nga PSRK, Ilirjana Çollaku – Tafa, Milot Krasniqi, Ilir Morina, po ashtu kanë marrë pjesë, i akuzuari S B dhe mbrojtësit e tij avokatët Besnik Berisha dhe Veton Berisha sipas autorizimit.

Prokurorja e shtetit nga PSRK Ilirjana Çollaku Tafa, gjatë shqyrtimit gjyqësor ka qëndruar në tërësi pranë aktakuzës kundër të akuzuarit, andaj edhe ka propozuar që i njëjti të shpallet fajtor për veprat penale dhe të dënohet sipas ligjit.

I akuzuari S B, gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk e ka pranuar fajësinë për veprat penale për të cilat është ngarkuar me aktakuzë.

## 2. Fjala përfundimtare e palëve

Prokurori i shtetit i PSRK-së Ilir Morina, ka marr pjesë gjatë shqyrtimit gjyqësor, përkatësisht gjatë paraqitjes së fjalës përfundimtare të cilën e kish përgatitur me shkrim prokurorja Ilirjana Qollaku Tafa, mirëpo elaborimin gjatë kësaj seance gojarisht e ka bërë nga prokurori Ilir Morina, i cili ka deklaruar se: Prokurori i Shtetit vlerëson se, se përgjatë gjithë shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se i akuzuari S B ka kryer veprat penale, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivët e aktakuzës. I akuzuari S B është vërtetuar se për interesat e veta për përfitim personal kishte vepruar në kundërshtim me të gjitha normat ligjore, pasi që në mënyrë të drejtpërdrejtë, kishte kërkuar dhe kishte pranuar përfitim në mënyrë që të veprojë në kundërshtim me detyrën e tij zyrtare. Poashtu, se i akuzuari S B, gjyqtar i cili ndër llojet e veprave penale që i kishte gjykuar gjatë ushtrimit të detyrës së tij kishte gjykuar edhe veprat penale të armëmbajtjes së paligjshme, ku i njëjti ishte vet personalisht posedues i armës në kundërshtim me ligjin. Përgjatë shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar fakti se i akuzuari S B si person zyrtar-gjyqtar në Gjykatën Themelore në Pejë-Departamenti për Krime të Rënda, në mënyrë të drejtpërdrejtë ka kërkuar dhe ka pranuar përfitim në mënyrë që të veprojë në kundërshtim me detyrën e tij zyrtare, ashtu që me datë 19.09.2019, i akuzuari ishte takuar me dëshmitarin F Z tek restoranti “Toni” në Pejë, dhe pas përfundimit të drekës, të njëjtit kanë shkuar tek vetura e dëshmitarit dhe pasi që kanë hyrë brenda, i akuzuari ka pranuar nga dëshmitari shumën e parave në vlerë prej 2.000.00 (dy mijë) euro, për shkak se i akuzuari ishte dakorduar

---

regjistruar me audio ose video incizim për shkak të mungesës së këtyre pajisjeve në gjykatë në kohën kur janë mbajtur seancat e shqyrtimit gjyqësor.

me dëshmitarin që në rastin penal ku i akuzuar ishte vëllai i dëshmitarit F Z, në të cilin rast i akuzuari ishte kryetar i trupit gjykues, vëllaut të dëshmitarit t'i shqiptojë dënim më të favorshëm, me ç'rast i akuzuari ka marrur aktgjykimin me shenjën PKR.nr..., me të cilin ka shqiptuar dënim të kushtëzuar, e që të gjitha veprimet e të akuzuarit e përbëjnë figurën e veprës penale Marrja e ryshfetit, e sanksionuar sipas nenit 421 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së, dhe veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve, e sanksionuar sipas nenit 366 par.1 të KPRK-së. Nga provat e administruara përgjatë shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar fakti se i akuzuari S B nuk kishte vepruar në pajtim me detyrat e tij zyrtare, pasi që i njëjti kishte shkelur ligjin kur kishte gjykuar vëllain e dëshmitarit F Z duke e favorizuar atë, dhe se i njëjti me datë 19.09.2019 nga dëshmitari F , pikërisht për favoret që i kishte bërë gjatë zhvillimit të procedurës penale ndaj vëllait të tij M Z, kishte pranuar përfitim për veten e tij dhe atë shumë prej 2000 ( dymije) euro, e poashtu nga dëshmia e dëshmitarit F Z, vërtetohet se i akuzuari edhe më herët kishte pranuar përfitim pasurore. Dëshmitari F Z në deklaratën e dhënë në Policinë e Kosovës, me datë 23.09.2019, ndër të tjera kishte theksuar se:” *Pas kontaktit me gjyqtarin S B jemi takuar edhe fizikisht ku kemi biseduar për obligimet e mbetura para dy apo tre viteve të cilat i kam thënë se jam i gatshëm t’ia paguaj... dhe se pas takimit në restorant “Toni” në Pejë me gjyqtarin S B, të njëjtit i kam treguar se i kam sjellur mjetet sipas marrëveshjes, dhe i kam treguar se paratë i kam tek vetura ime, ku i kam treguar se janë dy zarfa me nga një mijë euro, më ka pyetur se a i ke numërua unë i kam thënë po, numëroj nëse nuk më beson pastaj i ka marrë i ka bërë zarfat dyfish dhe i ka shti në xhep më ka falenderuar dhe më ka thënë takohemi prapë”.* Prokurorja, thekson faktin se këto dëshmia të dhëna nga dëshmitari F Z, janë marrur në pajtim të plotë me dispozitat ligjore të KPP-së, dhe të cilat e vërtetojnë gjendjen faktike të përshkruar si në aktakuzë, dhe saktësia e tyre vërtetohet edhe me të gjitha provat e tjera që vërtetojnë se në veprimet e të akuzuarit S B janë realizuar tiparet e veprës penale Marrja e ryshfetit. Dëshmitari F Z përgjatë shqyrtimit gjyqësor pothuajse ka mohuar të gjitha ato të cilat i ka deklaruar në procedurën paraprake, si dhe përgjatë shqyrtimit gjyqësor dëshmitari F Z kishte dhënë përgjithësisht deklaratë jo logjike, kontradiktore dhe të pabesueshme, për faktin se për shumë elemente i njëjti deklarohet se gjoja se nuk më kujtohen shumë gjëra, për çka dhe prokuroria për të vërtetuar faktet si në aktakuzë, ka propozuar që të dëgjohen dhe dëshmitarët V Sh dhe Z S të cilët ishin zyrtar policor në procedurën paraprake gjatë dhënies së deklaratës së dëshmitarit F Z. Gjatë dëgjimit të zyrtarit policor në cilësinë e dëshmitarit V Sh, hetues i rastit përgjatë shqyrtimit gjyqësor kishte dhënë një deklaram të detajuar lidhur me procedurën e zhvilluar hetimore në këtë çështje penale, ku i njëjti kishte sqaruar jo vetëm rolin e tij gjatë hetimeve në rastin konkret, por dhe të kolegëve të tij që kishin marrë pjesë në hetimin e rastit, ndër ta dhe Z S, për të cilin dhe është tërhequr propozimi për dëgjimin e të

njëjtin në cilësinë e dëshmitarit. Gjatë dëgjimit të dëshmitarit V Sh është vërtetuar se procedura e hetimit në rastin konkret ishte udhëhequr me rregullësi të plotë bazuar në dispozitat e KPP-se, gjë që dëshmohej edhe me dokumentet dhe raportet policore e të cilat janë pjesë e dosjes. Rrjedhimisht, pas dëgjimit të dëshmitarit V Sh, është vërtetuar se deklaratat e dëshmitarit F Z dhënë gjatë procedurës hetimore në këtë çështje penale janë të sakta, të vërteta dhe të mbështetura edhe me provat e tjera material të administruara përgjatë shqyrtimit gjyqësor. Ndërsa në anën tjetër është e pasaktë pjesa e dëshmisë së dëshmitarit F Z, dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor se kinse hetuesi V Sh dhe Z S ishin ata që dëshminë e dëshmitarit F Z dhënë gjatë hetimeve që inkriminonte të akuzuarin S B e kishin shkruar, ja kishin lexuar dhe gjoja nga ai kishin kërkuar vetëm ta nënshkruante. Ky deklaram është i pavërtetë, pasi që dhe nga dëshmia e dëshmitarit V Sh u vërtetua se si zyrtar policor i ngarkuar me hetimin e rastit që është objekt i aktakuzës, të njëjtin rast e kishin hetuar konform dispozitave të KPP-së, ashtu siç e kërkon ligji. Dëshmia e dëshmitarit V Sh është kredibile, duke qenë se i njëjti është me eksperiencë të gjatë në polici dhe gjatë përvojës së tij, nuk kishte pasur asnjë masë disiplinore dhe ndaj tij asnjëherë nuk është zhvilluar ndonjë procedurë penale që ndërlidhet me detyrën e tij zyrtare. Nuk ekziston asnjë provë e vetme përveç thënieve të dëshmitarit F Z gjatë shqyrtimit gjyqësor, që do të çonte në dyshim nëse V Sh, Z S apo dikush tjetër e kishte shkruar deklaratën e F Z. Pretendimi i mbrojtjes se gjoja dëshmitari V Sh për të deklaruar në mënyrën e tillë ishte udhëzuar nga Prokuroria, nuk përkon me të vërtetën dhe nuk mbështetet me asnjë provë, por është thjesht një supozim i mbrojtjes për të ulur kredibilitetin e dëshmitarit të propozuar nga prokuroria. Se i akuzuari S B ka kryer veprat për të cilat akuzohet dhe se në veprimet e tij formësohen tiparet e veprave penale për të cilat akuzohet, dëshmojnë dhe provat tjera material, të siguruar me masa të fshehta të hetimit dhe vëzhgimit të urdhëruara nga gjykata na bazë të dispozitave ligjore të KPP-se, e që vërtetohen dhe nga biseda në video incizimin në mes të dëshmitarit F Z dhe të akuzuarit S B. E që nga video-incizimin, biseda e cila është dëgjuar, e njëjta nuk është një trillim i një personi të caktuar ashtu siç pretendon mbrojtja, mirëpo është fakti se i akuzuari S B, pas përfundimit të orarit të punës si gjyqtar, me veturën e tij kishte shkruar në vendtakimin e caktuar më parë ku në kohën e caktuar e priste dëshmitari F Z, për të marrë pjesën e mbetur të shumës së ryshfetit për favorët të cilat i'a kishte kryer më parë atij duke keqpërdorur detyrën e tij. Sa i përket provave të paraqitura nga mbrojtësi i të akuzuarit, dhe atë deklaratat e O B e dhënë me datë 09.09.2020 pranë noterit Y M, prokurorja e shtetit e konsideron se leximi i një deklarate të tillë që tani i ndjeri kishte dhënë para noterit, nuk i përmbush kriteret ligjore për leximin e deklaratave të dhëna më parë në kuptim të nenit 335 të KPP-se, dhe se i njëjti nuk kishte dhënë asnjëherë ndonjë dëshmi pranë organeve kompetente. Për më tepër, prokuroria konsideron se kjo provë është qartazi e parëndësishme dhe thelbësisht e pambështetshme në kuptim të nenit 253 të KPP-së.



Tutje, prokurorja e shtetit thekson se sa i përket deklaratës së dëshmitares T Th lidhur me mjetet e sekuestruara nga banesa e të akuzuarit S B në shumë prej 10.000.00 euro, nuk del të jetë e besueshme, marrë parasysh se përveç rastit konkret, dëshmohet se i akuzuari edhe në të kaluarën kishte qenë i përfshirë në vepra penale të marrjes së ryshfetit, çoftë me pjesën e parë të shumës së të hollave që kishte marrë nga dëshmitari F Z për rastin e vëllait të tij apo tek rastet e tjera për të cilat edhe bisedojnë gjatë takimit të regjistruar, e që vërtetohet fakti se kjo shumë e të hollave i takonte të akuzuarit S B dhe jo motrës së gruas së tij. Poashtu, sa i përket deklaratës së dëshmitares Z Th, dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor e cila kishte deklaruar se arma e gjetur në dhomën e të akuzuarit i takonte vëllait të të akuzuarit, nuk është e besueshme dhe nuk gjen mbështetje në prova të tjera, dhe se pretendimi se kunati i saj S e kishte lënë armën në dhomën e të akuzuarit pa e ditur ai, gjoja me arsyetimin e udhëtimit të tij në Rozhajë, del të jetë pretendim i pabesueshëm dhe i pasaktë, meqënëse nga prova e nxjerrë nga të dhënat e sistemit kufitar me kërkesë të prokurorisë del se ai person nuk kishte udhëtuar për në Rozhajë në datën e dhënë nga dëshmitarja. Tutje prokurorja e shtetit në fjalën përfundimtare ka theksuar se sa i përket mbrojtjes së të akuzuarit i njëjti fillimisht kishte thënë se do të deklarohej, mëpastaj i njëjti përmes mbrojtësi të tij deklaroi se do të zgjedhë të drejtën që të mbrohet në heshtje. Lidhur me këtë konsiderojmë se dispozitat e KPP-së përcaktojnë në mënyrë të qartë mënyrën e marrjes në pyetje të të akuzuarit gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe ka përcaktuar se nëse ai zgjedhë që të deklarohet marrja e tij në pyetje do të zbatohet në pajtim me dispozitat ligjore për marrjen në pyetje të të akuzuarit, pra ligji nuk ka përcaktuar kombinim të këtyre dispozitave ligjore. Nga të lartcekurat i propozojmë gjykatës që të konsiderojë se i akuzuari në pajtim me dispozitën e nenit 334 par.1, ka zgjedhur të drejtën e tij të mos deklarojë, ashtu siç edhe është shprehur në seancën gjyqësore të datës 21.03.2023, prandaj të mos marrë parasysh asnjë nga deklaratimet e tij të dhëna në pyetjet e avokatit të tij mbrojtës. Gjykatës me rastin e marrjes së dënimit ndaj të akuzuarit, i propozojmë që të marrë parasysh mirëpo mos të kufizohet në rrethanat rënduese e që janë, shkalla e lartë e dashjes, keqpërdorimi i pozitës zyrtare dhe motivi për kryerjen e veprës penale, dhe gjykata poashtu të marrë për bazë faktin se i akuzuari përgjatë gjithë shqyrtimit gjyqësor nuk është penduar në kryerjen e veprave penale për të cilat akuzohet dhe se i njëjti nuk ka kërkuar falje. Po ashtu, trupit gjykues i propozojmë që me rastin e marrjes së vendimit të konfiskohen dhe paratë në vlerë prej 10.000.00 (dhjetëmijë) euro, të gjetura dhe të sekuestruara me rastin e kontrollit të banesës së të akuzuarit. Të konfiskohet arma e tipit “Zaza Mini”, e kalibrit 8mm, me numër serik T.592372 dhe shtatë fishekë. Në fjalën përfundimtare prokurorja e shtetit thekson faktin që në mungesë të rrethanave lehtësuese nga ana e trupit gjykues të vlerësohen ato të natyrës rënduese ndaj të akuzuarit me rastin e shpalljes fajtor të të njëjtit.

Mbrojtësi i të akuzuarit S B, av. Besnik Berisha, në fjalën përfundimtare të përgatitur me shkrim dhe të elaboruar gojarisht, ka deklaruar se: në bazë të provave me të cilën është akuzuar i mbrojturi im të njëjtat prova kanë qenë të kundërligjshme, dhe atë provat materiale si CD e datës 19.09.2019, fotoincizimet 030-v-2019, CD me video në automjet në trup, videos së kontrollit në trup dhe raportit të vëzhgimit të datës 19.09.2019, pasi që këto prova janë marrur në kundërshtim me dispozitat e KPP-se dhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, gjegjësisht nenin 36.3, që përcakton të drejtën për privatësi, e për të cilën dhe GJEDNJ ka vendosur standartin e autorizimeve për masa të fshehta të hetimit dhe vëzhgimit, siç është rasti i Basic v Croatia SS 32-36 dhe rastet të tjera, dhe nën këtë arsyetim mbrojtja thekson se në rastin konkret urdhëresat e precizuara më lartë janë të kundërligjshme, sepse GJPP ka dështuar që të arsyetojë rrethanat specifike dhe individuale të rastit, arsyet si dhe pse informacioni i siguruar përmes masës hetimore të fshehtë ka gjasa që të ndihmojë në hetimin e veprës penale dhe përse hetimi nuk mund të kryhej nëpërmjet mjeteve të tjera hetimore me invazive. Në rastin konkret GJPP për të nxjerrur urdhrat në fjalë, në dispozitën e nenit 88 të KPP-së, parashihen tri kushte kumulative (dhe jo alternative) të cilat duhen përmbushur me rastin e nxjerrjes së një urdhri për masa të fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit lidhen me, ekzistimin e dyshimit të bazuar, ndihmën që mund të sjellë masa në fjalë në hetimin e veprës penale dhe pamundësinë e marrjes së saj nëpërmjet masave hetimore më pak invazive. Ashtu siç rezulton dhe nga praktikat e GJEDNJ, plotësimi i të gjitha këtyre kushteve kërkon arsyetim adekuat, i cili rrjedh nga parimi i arsyetimit të vendimeve gjyqësor dhe në përgjithësi nga detyrimi i gjykatës për të mbrojtur të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të garantuara më kushtetutë dhe konventa ndërkombëtare. Mbrojtja thekson se GJPP me rastin e lëshimit të urdhëresave të kundërshtuara ka dështuar që të vlerësojë dhe arsyetojë plotësimin e kushteve procedurale të parapara me ligj, në mënyrë të veçantë të atyre kushteve që lidhen me analizimin e rrethanave specifike dhe individuale, si dhe arsyeve se përse masat e fshehta teknike të vëzhgimit dhe hetimit ishin të domosdoshme në rastin konkret dhe nuk mund të zëvendësoheshin me masa të tjera më pak invazive. Mbrojtja tutje thekson se, urdhëresat për autorizimin e masave të fshehta kanë rezultuar në shkelje të drejtës kushtetuese për privatësi. Në rastin e të mbrojturit tim S B, në vend të arsyetimit të detajuar mbi rrethanat specifike individuale të rastit, si dhe mbi domosdoshmërinë dhe proporcionalitetin e masave të fshehta, udhëresat e kundërshtuara, pas përshkrimit sipërfaqësor të dyshimit të bazuar, i cili është vetëm njëri prej kushteve procedurale, urdhëresat e lartpërmendura nuk përmbajnë asnjë arsyetim të vetëm mbi faktet vendimtare, rrethanat specifike dhe gjendjen faktike konkrete të çështjes penale ndaj të mbrojturit tim, domosdoshmërinë dhe proporcionalitetin e masave të fshehta, arsyet se si dhe pse informacioni i siguruar përmes masës ka gjasa që të ndihmojë në hetimin e veprës penale, arsyen se përse informacioni nuk do të kishte mundësi që të merrej

nëpërmjet masave të tjera hetimore, pa shkaktuar vështirësi të paarsyeshme ose rrezik potencial për të tjerët. Andaj, mangësitë substanciale të arsytimit, standarti i të cilit buron nga parimet e vendimeve të GJEDNJ, i bëjnë të kundërligjshme dhe kundërkushtetuese urdhëresat e kundërshtuara, respektivisht në shkelje të nenit 8 të KEDNJ dhe nenit 39.3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Poashtu, mbrojtja ka kundërshtuar dhe procesverbalin mbi kontrollin e personit dhe shtëpisë së lokaleve dhe pronës me shenjë 2019 KE 372, dt 19.09.2019, fotodokumentacioni nga vendi i bastisjes dt 19.09.2019 dhe listës së armëve dhe municionit të konfiskuar me numër 2019-DA-188, dt 19.09.2019, për arsye se të njëjtat prova janë në kundërshtim me nenin 249.1, nënpar 1.2, lidhur me nenet 111.1, nënpar 1.6 dhe 1.7 dhe 257.2 të KPP-së, për arsye se gjatë kontrollit të banesës nuk kanë marrë pjesë dy dëshmitarë të moshës madhore, por vetëm i mbrojturi im dhe familja e tij, të cilët gëzojnë statusin e dëshmitarit të privilegjuar dhe si të tillë të njëjtit janë të liruar nga detyra e dëshmitarit. Lirimi i dëshmitarëve nga detyrimi për të qenë dëshmitar dhe statusi i tyre si dëshmitar të privilegjuar, shkakton që kontrolli i banesës së të mbrojturit tim të jetë kryer në kundërshtim me nenin 108.2 të KPP-së, për shkak të mungesës së dëshmitarit të dytë të pavarur, të moshës madhore, çka rezulton drejtpërsëdrejti në papranueshmëri të provave të siguruara gjatë bastisjes në kuptim të nenit 111.1 nënpar.1.6 të KPP-së. Gjithashtu, mbrojtja në fjalën përfundimtare thekson se gjatë bastisjes ka munguar edhe avokati i autorizuar nga i mbrojturi im, dhe se avokati me emër Jakup Qeku përveç që nuk ka qenë i pranishëm gjatë bastisjes dhe nuk ka pasur asnjë autorizim për përfaqësim, i njëjti procesverbalin e ka nënshkruar në polici, pas kërkesës së zyrtarëve policor për të nënshkruar. Poashtu dhe sipas pohimeve të të mbrojturit tim, dëshmitarja tjetër Z H, që ka nënshkruar procesverbalin mbi kontrollin e personit dhe shtëpisë, lokaleve dhe pronës, me shenjë 2019 KE 372 të datës 19.09.2019 nuk ka qenë e pranishme gjatë kontrollit, por ka ardhur pas përfundimit të tij dhe ka nënshkruar se kinse ka qenë prezente gjatë bastisjes. Të njëjta rrethana të lartëcekura kontrollin e përfshijnë në shkelje esenciale në kuptim të nenit 108.1 të KPP-së, dhe drejtpërsëdrejti rezulton në prova të papranueshme. Mbrojtësi i të akuzuarit në fjalën përfundimtare, ka kundërshtuar dhe deklaratën e dëshmitarit F Z të dhënë në polici me datë 09.09.2019 dhe 23.09.2019, nën arsytimin se të njëjtat në kuptim të nenit 123.2 të KPPRK-së, parashikon se provat e siguruara gjatë marrjes në pyetje në procedurë paraprake nuk mund të përdoren si provë e drejtpërdrejtë gjatë shqyrtimit kryesor, por mund të përdoret gjatë marrjes së tërthortë në pyetje për vënien në dyshim të dëshmitarëve nëse dëshmitari ka dëshmuar ndryshe nga dëshmia e dhënë gjatë marrjes në pyetje në procedurë paraprake. Në procedurë paraprake gjatë marrjes në pyetje të të njëjtit, të mbrojturit tim dhe mua si mbrojtës na është mohuar parimi i kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve, pasi që i mbrojturi im objektivisht e ka pasur të pamundur për të sfiduar kredibilitetin e dëshmisë së dëshmitarit në atë stad të procedurës penale.

Mbrojtja, gjithashtu kundërshton raportin e ekspertimit të AKF me numër referues AKF/2020-0463/2020-416, dt 18.05.2020, nën arsyetimin se në kohën e ngritjes së aktakuzës kjo provë materiale nuk ka ekzistuar në shkresat e lëndës, si dhe PSRK, pas 2 vitesh ka propozuar një provë të tillë materiale për të mbështetur pikën II të aktakuzës. Përgjatë gjithë shqyrtimit gjyqësor, mbrojtja në fjalën përfundimtare thekson se është vërtetuar motivi i dëshmitarit F Z për të denoncuar rrejtshëm të mbrojtur tim në këmbim të dënimit të tij, faktin se dëshmitari ka siguruar numrin e telefonit të të mbrojtur tim nga rojet e gjykatës, i cili kishte insistuar për takim me të mbrojtur tim e të cilin nuk e kishte takuar kurrë më parë, fakti se përgjatë qëndrimit në restorant Toni nuk është folur kurrë për ndonjë ryshfet, të njëjtat nga dëshmitari kanë qenë trillime dhe kamuflim i fakteve dhe rrethanave të paraqitura gjatë bisedës. Mbrojtja në fjalën përfundimtare deklaron se, i mbrojturi im S B asnjëherë nuk ka kërcënuar dëshmitarin F Z, dhe se i njëjti nuk ka kërkuar dhe as pranuar kurrë ryshfet për vete, në emër të shqiptimit një dënimi më të favorshëm kundër të pandehurit M Z, si dhe sanksioni penal i shqiptuar me aktgjykimin PKR.P.nr... të datës 21.12.2015, kundër të pandehurit M Z, vëllau i dëshmitarit F Z, nuk është apeluar nga Prokuroria dhe i njëjti dënim i shqiptuar është konform praktikës gjyqësore në raste të ngjashme, dhe se shuma prej 10.000.00 euro, e gjetur në shtëpinë e të mbrojtur tim gjatë bastisjes, i përket znj.T Th, kumatës së të mbrojtur tim. Ndërsa sa i përket revoles së tipit “Zaza Mini” kal 8mm, me numër serik T.592372 e gjetur në shtëpinë e të mbrojtur tim, e njëjta revole i përket vëllait të tij z.S B. Mbrojtësi, thekson se motivi i dëshmitarit F Z për të denoncuar rrejtshëm të mbrojtur tim, nuk ka qenë për kërkim të ryshfetit por për të këmbyer sanksionin penal që i ishte shqiptuar atij me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë, dt 28.02.2018. Nga dëshmia e dëshmitarit F Z, dhënë përgjatë shqyrtimit gjyqësor, rezulton se dëshmia e dhënë në polici është përpiluar dhe përgaditur nga zyrtarët policor, dhe se e njëjta është e pavërtetë në përmbajtjen e saj dhe se është nënshkruar nga dëshmitari me bindjen se duke vepruar në këtë mënyrë ai do t’i shpëtonte ndjekjes penale për veprat e tij dhe do të shmangte vuajtjen e dënimit me burg. Mbrojtja në fjalën përfundimtare ka elaboruar dëshminë e dëshmitarit të dhënë në shqyrtimin gjyqësor të datës 23.09.2021, në të cilën ka elaboruar pyetjet nga ana e PSRK dhe mbrojtësit të të akuzuarit, si dhe përgjigjet e dëshmitarit, e të cilat mbrojtja i konsideron si trillime dhe shpikje të dëshmitarit lidhur me denoncimet e bëra me qëllimin e vetëm për t’iu shmangur ndjekjes penale në raport me veprat e kryera nga i njëjti. Përgjatë shqyrtimit gjyqësor, dëshmitari ka theksuar se asnjëherë nuk ka shkuar në polici për të denoncuar të mbrojtur tim, por se emri i të njëjtit ka qenë rezultat i pyetjes që policët hetues i kishin bërë dhe qëllimit të këtyre policëve për të shpikur ndonjë provë që do të kishte rezultuar me burgosjen e të mbrojtur tim. Dëshmitari F Z përgjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 17.11.2021 ka përsëritur pohimin e rrejtshëm të dhënë nga policia, se kinse i njëjti do të trajtohej si dëshmitar bashkëpunues, me të vetmin qëllim që t’i

shmangej ekzekutimit të dënimit me burgim. Mbrojtja tutje për të elaboruar motivin e dëshmitarit F Z ka përshkruar të kaluarën kriminale të të njëjtit, duke e cilësuar të njëjtin si një gënjeshtar dhe mashtrues. Tutje, mbrojtja thekson se dëshmitari numrin e telefonit të mbrojturit tim e ka siguruar nga rojet e gjykatës dhe që i njëjti kishte insistuar për takim me S B, të cilin nuk e kishte takuar kurrë më parë, duke u shtirur si familjar i të mbrojturit tim për ti kërkuar takim, duke shpikur arsye të ndryshme për tu takuar me të mbrojturin tim dhe vetëm pas insistimit i mbrojturi im kishte pranuar ftesën për takim. Përgjatë shqyrtimit gjyqësor, është vërtetuar fakti se gjatë drekës në mes të mbrojturit tim dhe dëshmitarit nuk është folur asnjëherë për ryshfet, apo për para, sepse dëshmitari F Z nën nxitjen e Policisë dhe me qëllim të realizimit të interesit të tij për t'iu shmangur burgut nuk ka guxuar të përmendë para gjatë drekës, me frikën që i mbrojturi im S B do të qohej nga tavolina, e të cilën dëshmitari e ka përshkruar në mënyrë të detajuar gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 17.11.2021, mbi atë se çka është diskutuar gjatë drekës në restorant Toni dhe veçanërisht është folur për para, ku dëshmitari në pyetjen e PSRK, kishte deklaruar se” *Nuk kemi pasur llaf të mjeteve(parave) asnjëherë*” dhe në pyetjen e PSRK-së së:” *As gjatë drekës nuk keni përmendur mjetet-paratë*”, dëshmitari ishte përgjigjur se” *Me dije jo, por nuk më kujtohet, për këtë janë incizimet dhe i bindur jam se nuk kam përmendur se jam frikësu se mos po çohet prej tavoline*”. Përgjatë shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar se pas drekës, gjatë qëndrimit në automjet, në momentin e dhënies së zarfit me para, dëshmitari F Z ka trilluar dhe kamufluar faktet dhe rrethanat e paraqitura gjatë bisedës së përgjuar, në mënyrë që i mbrojturi im vërtet të kujtonte se dëshmitari kishte folur me gjyqtarin S B dhe se bëhej fjalë për dhuratë pa ndonjë qëllim të përcaktuar. Edhe në ballafaqimin e KTGJ lidhur me përmbajtjen e bisedës së zhvilluar në automjet, e cila ka qenë subjekt i masave të fshehta teknike të vëzhgimit dhe hetimit, dëshmitari F Z ka deklaruar se përmbajtja e bisedës në fjalë ka qenë e trilluar dhe kamufluar kryekëput në bazë të motivit të dëshmitarit për të denoncuar me çdo kusht të mbrojturin tim S B, me qëllim që në këtë mënyrë t'i shmangej ekzekutimit të dënimit me burg. E për faktin se dëshmia e dëshmitarit ka qenë trillim i vërtetë, e dëshmon fakti se i njëjti pas pyetjes së KTGJ nëse ka diçka për të shtuar, dëshmitari kishte deklaruar se i kërkon falje të mbrojturit tim për përfshirjen e tij në këtë çështje dhe dëmet e shkaktuara. Po ashtu i mbrojturi im nuk ka kanosur asnjëherë për asnjë moment dëshmitarin F Z, i cili po ashtu ka pohuar përgjatë shqyrtimit gjyqësor se te mbrojturin tim as nuk e ka njohur dhe as familjaret e te njëjtit nuk i njeh. Mbrojtësi i te pandehurit ne fjalën përfundimtare thekson faktin se S B asnjëherë nuk ka kërkuar apo pranuar para ryshfet në emër të shqiptimit të një dënimi më të butë për vëllain e dëshmitarit, kjo vërtetohet dhe nga dëshmia e dëshmitarit F Z, dhënë në shqyrtimin gjyqësor me datë 23.09.2021 dhe po ashtu nga fakti se Prokuroria nuk kishte apeluar aktgjykimin në fjalë. Ndërsa lidhur me faktin e shumës së parave në vlerë prej 10.000,00 euro të gjetura në shtëpinë e

të mbrojturit tim, të njëjta i përkasin znj. T Th, kunatës së të mbrojturit tim e cila dhe vet personalisht në dëshminë e saj me date 08.11.2022, ka pohuar se mjetet ka qenë të sajat dhe jo të të mbrojturit tim. Ndërsa, lidhur me revolen që kanë gjetur gjatë bastisjes, mbrojtja thekson faktin se e njëjta është e vëllaut të të akuzuarit, dhe këtë fakt e pohon dhe dëshmitarja Z Th në shqyrtimin e datës 08.11.2022. Ndërsa, dëshmia e dëshmitarit V Sh dhënë në shqyrtimin gjyqësor, mbrojtja thekson se e njëjta është jokredibile, pasi që i njëjti nuk ka arritur që të argumentojë shumë aspekte kryesore të procedurës hetimore të ndjekur ndaj të mbrojturit tim, për arsye se i njëjti në pyetjet e parashtruar përgjatë shqyrtimit gjyqësor nga PSRK, i'u ishte përgjigjur me saktësi çdo pyetje, ndërsa kur shfaqeshin rrethana apo fakte shfajësuese për të mbrojturin tim, i njëjti përgjigjej me atë se nuk i kujtohej si dhe i njëjti dëshmitar gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk ka qenë në gjendje të shpjegojë arsyet se përse nuk ka hartuar raport policor për komunikimet zyrtare që ka pasur me dëshmitarin F Z, edhe pse ka pohuar se për çdo komunikim zyrtar përpilohet raport lidhur me përmbajtjen e komunikimit. Përgjatë shqyrtimit gjyqësor mbrojtja thekson se nuk janë provuar asnjëri nga faktet vendimtare të përshkruara në dispozitivin e aktakuzës nga PSRK, dhe se përjashtohet mundësia në çdo rrethanë që i mbrojturi im kinse i ka kërkuar para dëshmitari në mënyrë që vëllait të dëshmitarit ti shqiptonte një sanksion penal më të butë ndaj këtij të fundit. Po ashtu, dhe nga vet deklarimi i dëshmitarit F Z në shqyrtimin e datës 09.09.2019, përgjatë dëshmisë së tij i njëjti ka përshkruar vazhdimisht si protagonist kryesor përgjatë bisedës gjyqtarin S B, emri i të cilit lakohet nga dëshmitari si personi që ka kërkuar dhe pranuar paratë, madje dhe si personi që ka ushtruar presion mbi dëshmitarin për të paguar dhe pjesën tjetër të mbetur. Për më tepër ryshfeti i pretenduar është dhënë në mënyrë që vëllait të dëshmitarit t'i caktohej një masë sigurie më e butë, më saktësisht ajo e dorëzanisë, pra mjetet në fjalë nuk ishin dhënë më qëllim të një sanksioni penal më të butë siç përshkruhet nga ana e PSRK. Për vëmendjen e trupit gjykues mbrojtja thekson se karshi gjyqtarit S B si personi që ka bërë presion për shumën prej 2.000.00 euro, PSRK ka pushuar hetimet, për shkak se nuk ka gjetur elemente inkriminuese. I mbrojturi im S B nga ana e PSRK përgjatë shqyrtimit gjyqësor nuk është provuar se i njëjti ka vepruar në kundërshtim me detyrën zyrtare, përmes shqiptimit të dënimit për vëllaun e dëshmitarit, M Z. Për më tepër PSRK ka dështuar të argumentojë se cila ishte detyra zyrtare e të mbrojturit tim, dhe se cilat janë arsyet që e mbështesin pretendimin se i mbrojturi im ka vepruar në kundërshtim me detyrën e tij zyrtare, përkatësisht në kundërshtim me cilin obligim, apo dispozitë ligjore që përkufizon detyrat e gjyqtarit ka vepruar i mbrojturi im. Lidhur me pretendimin se i mbrojturi im ka kryer veprën penale nga neni 421 të KPRK-së, një fakt i tillë nuk është provuar përgjatë gjithë shqyrtimit gjyqësor, ngasë nuk është provuar lidhja shkakësore midis veprimit dhe pasojës, sepse veprimi i pranimit të shumës prej 2000 euro nuk ka asnjë lidhmëri me nxjerrjen e aktgjykimit në fjalë, pasi që i njëjti ishte nxjerrë 3 vjet e gjysmë

më parë, dhe e cila përbënte çështje tashmë të gjykuar për vëllaun e dëshmitarit, rrjedhimisht nuk ekzistonte asnjë mundësi objektive e vetme për të vepruar në kundërshtim me detyrën zyrtare ashtu siç akuzohet nga ana e PSRK i mbrojturi im. Tutje, mbrojtësi thekson se ndaj të akuzuarit S B, i njëjti është gjykuar pa u hetuar fillimisht nga PSRK, sepse i njëjti nuk është hetuar kurrë për veprën penale Marrja e ryshfetit nga neni 421 të KPRK-së. Nga aktvendimi për zgjerimin e hetimit nga PSRK me datë 20.09.2020, i akuzuari është hetuar për veprat penale Keqpërdorim i pozitës, apo autoritetit zyrtare, nga neni 414 par.1 të KPRK-së dhe veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim, apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve, nga neni 374 par.1 të KPRK-së. Ndërsa me datë 05.02.2020, PSRK ka dorëzuar pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti Special, aktakuzën me numër PPS.nr.52/2019, me të cilën i akuzuari S B akuzohej për veprat penale Marrja e ryshfetit, nga neni 421 të KPRK-së dhe veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim, apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve, nga neni 374 par.1 të KPRK-së, pra për veprën penale Marrja e ryshfetit PSRK nuk ka hetuar fare, kjo vërtetohet dhe në bazë të shkresave të lëndës nga ku shihet se nuk ka asnjë aktvendim formal për hetim në drejtim të kësaj vepre penale. Trupi gjykues përgjatë shqyrtimit gjyqësor ka refuzuar propozimet për dëgjimin e dëshmitarëve, çka ka rezultuar me cenim të drejtës kushtetuese për të mbrojturin tim për të marrë në pyetje dëshmitarët relevantë për zbardhjen e çështjes. Po ashtu, me refuzimin për kthim të telefonit, apo për sigurimin e bisedave të nxjerra nga i mbrojturi im, dhe refuzimin e propozimeve për administrimin e provave materiale, për mbrojtjen paraqet një cenim të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, pasi që të gjitha propozimet e refuzuara ishin të natyrës shfajësuese, dhe si të tilla të njëjtat do të kishin ndriçuar të gjitha rrethanat e çështjes ndaj të mbrojturit tim. Nga të lartcekurat, mbrojtja e të akuzuarit në fjalën përfundimtare ka theksuar që lidhur me ekzistimin e mëdyshjeve sa i përket fakteve të rëndësishme për këtë çështje penale, të zbatohet parimi in dubio pro reo ndaj të mbrojturit tim. Ndërsa, nga ana e trupit gjykues mbrojtja kërkon që ndaj të akuzuarit S B të nxjerrë aktgjykim lirues në kuptim të nenit 364 par.1 nënpar.1.3 të KPRK-së, për shkak se nuk është provuar se i njëjti ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

I akuzuari S B, në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: pajtohet me theksimet e mbrojtësit të tij dhe nuk kam çka të shtojë tjetër.

### 3. Provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor

Meqenëse i akuzuari S B, nuk e ka pranuar fajësinë për veprat penale për të cilat është ngarkuar me aktakuzë, gjykata për vërtetimin e gjendjeve faktike gjatë shqyrtimit gjyqësor ka bërë dëgjimin e dëshmitarëve dhe administrimin e këtyre provave dhe atë:

- Dëgjimin e dëshmitarëve: F Z, V Sh, T T dhe Z Th;
- Leximin e provave materiale, siç janë:
  - Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Pejë – Departamenti për Krime të Renda me shenjen PRK.P.nr. ..., i datës 05.01.2016, i plotfuqishëm me datë 15.02.2016;
  - Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Pejë – DKR me shenjen DKR.PP.nr..., i datës 27.06.2014;
  - CD – në e datës 19.09.2019, fotoinqizime 030-V-2019;
  - CD – në video në automjet, lokal dhe trup;
  - Videon e kontrollit në trup;
  - Procesverbalin mbi kontrollin e personit dhe shtëpisë, lokaleve dhe pronës me shenjen: 2019 KE 372, i datës 19.09.2019;
  - Foto dokumentacionin përkatësisht foto albumin e vendit të ngjarjes, i datës 19.09.2019,
  - Raportin e vëzhgimit të datës 19.09.2019;
  - Listën e armeve dhe municionit të konfiskuar, me numër 2019-DA-1888, të datës 19.09.2019;
  - Raportin e ekspertimit të AKF-së, me numër 2019-0379, për ekspertimin e telefonit të akuzuarit, i datës 13.12.2019;
  - Raportin njoftues lidhur me ekzaminimin e telefonit mobil, me numër 2019-KE 372, i datës 23.12.2019;
  - Raportin e këqyrjes së vendit të ngjarjes, me numër 2019-KE372, i datës 01.10.2019, i përpiluar nga Blerim Tigani;
  - Raportin e ekspertimit financiar, me numër 2019 KE-372, i datës 26.12.2019;
  - Raportin e ekspertimit të AKF-së, me numër referues AKF/2020 – 0463/2020-416, i datës 18.05.2020;
  - Deklaratën e dëshmitarit F Z të dhënë pranë Policisë së Kosovës NJH/KEK- Prishtinë, më datën 09.09.2019;
  - Deklaratën e dëshmitarit F Z, të dhënë pranë Policisë së Kosovës NJH/KEK- Prishtinë, më datë 23.09.2019;
  - Deklaratën e O B, e dhënë me datën 09.09.2020, pranë noterit Y M sipas numrit rendor 6825/20;



- Shkresën e sistemit të menaxhimit të kufirit, e datës 08.11.2022, për kalimin kufitar të personit S B, për periudhën 01.01.2019-09.11.2022, ora 08:03 minuta;
- Raportin njoftues me numër të referencës 2019 – KE-170, i datës 09.09.2019, i përpiluar nga rreshteri V Sh;
- Dëgjimin e mbrojtjes së të akuzuarit S B, i cili është përgjigjur vetëm në pyetje të mbrojtjes, ndërsa ka zgjedhur të drejtën e heshtjes për palët tjera dhe gjykatën.

### 3.1 Deklaratat e dëshmitarëve:

3.1.1 Dëshmitari F Z, në dëshminë e tij të dhënë në shqyrtimet gjyqësore të datave: 23.09.2021, 20.10.2021 dhe datës 17.11.2021, fillimisht ka deklaruar se të akuzuarin S B e njeh që një kohë të gjatë, kryesisht pas luftës pasi që dëshmitari kishte punuar si Taxi dhe se e ka njohur S B dhe e ka ditur që është gjyqtar, mirëpo nuk ka pasur ndonjë raport familjar apo shoqëror me të. Me tutje ka shtuar se vëllai i tij M Z, ka pasur një rast tek gjyqtari S B, për veprën penale Trafikim me migrantë, i cili ishte arrestuar nga policia e Istogut, mirëpo nuk ka qene ne paraburgim dhe se S B i kujtohet të ketë qenë si gjyqtar i trupit gjykues në këtë rast, ndërsa sa i përket seancës për caktimin e paraburgimit ndaj vëllait të tij M Zj, ku gjyqtar i procedurës paraprake ishte i akuzuari S B, dëshmitari deklaroi se ka marrë pjesë ne seancën dëgjimore dhe se vëllait të tij i është caktuar masa e dorëzatisë në vlere prej 3000 euro dhe është liruar në procedure te rregullt, dhe sa i përket prezencës ne seancë nuk i kujtohet që ti ketë thënë dikush që të dali jashtë apo se seanca është e mbyllur dhe se ai ka marrë pjesë në atë seance. Sa i përket aktgjykimit që është marrë ndaj vëllait të tij dëshmitari deklaroi se nuk është takuar ndonjëherë me të akuzuarin S në lidhje me dënimin apo aktgjykimin e marrë ndaj vëllait të tij. E pyetur nga prokurorja speciale se; “ *a ju kujtohet se në lidhje me rastin e vëllait tuaj keni dhënë një deklaratë në polici ne vitin 2019* “dëshmitari ka deklaruar se; “ *se me vet dëshirë kam shkuar në polici në Krimet Ekonomike dhe e kam denoncuar një gjyqtar dhe një prokuror për shkak së është ndier i kërcënuar nga ata dhe se majori Z Sdhe prokurori B I i kanë kërkuar një bashkëpunim për një gjyqtar tjetër*”. Ka theksuar se afër 3 muaj telefoni i tij ka qenë i përgjuar me lejen e tij dhe më pas i njëjti ka dhënë deklaratën në polici me datë 09.09.2019, të cilën deklaratë sipas tij, policia ia kanë lexuar dhe i njëjti e ka nënshkruar pa vërejtje, për arsye se për shkak të veprës për te cilën është akuzuar i njëjti, ka bashkëpunuar me policinë që ti fshihet vepra penale sipas tij, dhe të lirohet nga dënimi sepse ishte lodhur duke dhënë mjete. Ka shtuar se është detyruar që rastin me shku me lajmërua në Agjencinë Anti Korrupsion, sepse sipas tij për rastin për te cilin është dënuar ai ka qenë i pafajshëm dhe për shkak të mjeteve po e mbanin duke ia kthyer lëndën në rishqyrtim disa herë, dhe pastaj ka shkuar tek Sh mbiemri i të cilit nuk i kujtohet i cili ka qenë si udhëheqës në

Agjencinë AntiKorrupsion. Ka theksuar se as ai s' me ka besuar dhe në prezencë të tij e ka thirr dikënd në telefon, me telefonin te tij zyrtar, një gjyqtar që është i njohur për prokurorinë, dhe pastaj Shapi i ka thënë se unë nuk mundem me të ndihmua asgjë por shko në Policinë e Krimeve Ekonomike ata merren me këtë çështje dhe të ndihmojnë për veprën tënde dhe unë ashtu kam vepruar, dhe Sh ma ka bërë terminin që pas 2 dite për këtë që kam lajmëruar në AAK të shkoje tek oficeri Z S dhe V Sh, sepse personat të cilat i ka lajmëruar për korrupsion ende nuk janë arrestuar dhe ndihet i kërcënuar dhe i shantazhuar nga ata. Me tutje ka shtuar se me policinë ka bashkëpunuar që me mshel veprën penale të tij dhe se ka menduar me bind të akuzuarin S B për më ia dhanë ato mjete - te holla, por thekson se ka provuar edhe me një gjyqtar tjetër dhe një prokuror por pasi që kanë bashkëpunuar 3-4 muaj nuk kanë gjetur asgjë dhe është mbyllur rasti ndaj tyre. Ka deklaruar se orientimi ka qenë krejt dika tjetër, dhe hetuesit i kanë thënë se a njeh S B, se jemi duke e përgjuar dhe dëshmitari i ka thënë se mundem me provu me bashkëpunuar me ju. Me tutje ka mohuar që i akuzuari S B ti ketë kërkuar të holla apo dhurata drejtpërdrejtë ose përmes dikujt tjetër, përkundër faktit që në polici ka deklaruar se përpos rasteve te tjera që ka pasur me gjyqtarë te tjerë, i ka ndodhur edhe një rast në Gjykatën Themelore në Pejë ku për rastin e vëllait te tij M Z, gjyqtari S B përmes avokatit O B ka kërkuar që të takohet me te dhe pas takimit i ka kërkuar që ta kontaktoj gjyqtarin S B dhe për dorëzani ti lë shumën prej 3000 euro dhe si shpërblim për ata - gjyqtaret duhet të jap shumën prej 6000 euro....., ndërsa në dëshminë e tij në shqyrtimin gjyqësor e ka mohuar të këtë pasur kontakt prej asaj seance deri në ditën kur është arrestuar dhe se pyetur nga prokurorja se ; *“a jeni duke thënë se ju ne polici keni dhënë deklaratë të rrejshme”*, i njëjti nuk ka dashur të përgjigjet në këtë pyetje. Me tutje ka shtuar se gjatë vitit 2019, pas marrëveshjes që kishte pasur me policinë, me majorin Z S kishte shkuar në Gjykatën Themelore në Peje për të takuar të akuzuarin S B, mirëpo i njëjti nuk ka pranuar se ka qene i zënë me seancë dhe dëshmitari nga rojet e sigurimit te gjykatës e ka siguruar numrin e këtu të akuzuarit S, gjoja se e ka pjesëtar të familjes dhe kështu i ka shkruar vazhdimisht të akuzuarit S, por i njëjti nuk i është përgjigjur deri pas një muaj e gjysme ose 2 kur ka pranuar që të takohet, dhe se për çfarë arsye i ka thënë që të takohen dëshmitari ka deklaruar se nuk i kujtohet por me siguri i ka kërkuar ndonjë ndihme, ndërsa ne pyetjen e KTGJ-se se: *Meqenëse po thuani se keni kontaktuar disa herë me telefon, për çka e ke thirr ti S me u taku, çka i ke thënë, a të kujtohet*”, i njëjti është përgjigjur se: *“Për rastin e parë me kujtohet, se ka qene i konfiskuar dokumenti i vëllait tim dhe ngase dorëzanimin e patëm terhek e dokumentacionin hala, dhe me ka thënë që duhet me ju drejtu ose avokati ose me një shkresë në gjykatë dhe mundet me shku me terhek meqenëse është mbyllur çështja, dhe kam dalë me falënderua që po i kthen dokumentat se është mbyllur ajo çështje”*. Dëshmitari ka theksuar se ditën kur ka pranuar i akuzuari S B që të takohet me të, ka qenë pasi i akuzuari S i ka kryer punën e tij dikund pas orës 16:00, dhe po ashtu

atë ditë ka ftuar edhe “dajën”, mirëpo i njëjti nuk ka ardhur në këtë takim ngase ishte i sëmurë. Tutje ka shtuar se janë takuar në restorant “Toni” afër shtëpisë së të akuzuarit S dhe dëshmitari ka qene i ulur ne lokal dhe se më të hyre i akuzuari S ne restorant dëshmitari ka ngritur dorën sepse nuk e ka ditur nëse e njeh i akuzuari, dhe se dëshmitari ka qene i pajisur me mjete të policisë si pajisje për videoinqizime, kamera dhe jelek, si dhe më paratë në vlere prej 2000 Euro të cilat ia kishte dhënë policia, dhe ka qene i mbikëqyrur nga policia. Me tutje ka shtuar se pasi që kanë hëngër darke ia ka dhënë ato para për të cilat sipas dëshmitarit deklararon se i akuzuari ka menduar se ai zarf është ftesë për dasme. Po ashtu, dëshmitari ne shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se me të akuzuarin S B, nuk është takuar asnjëherë përpos ditës kritike, dhe se te gjitha ato që ka thënë në polici kanë qenë në bashkëpunim me polici me qëllim që i njëjti mos mu arrestu për Dhenje ryshfeti, dhe me iu hjek kjo vepër të cilën i njëjti tani është në vuajtje të dënimit, dhe i pyetur nga mbrojtësi av. Besnik Berisha se: *“ajo qe keni deklaruar ne polici a është ngjarje e vërtete”*, i njëjti deklaroi se; *“ato ngjarje nuk janë te vërteta”*, përkundër faktit që në polici ne deklaratën e tij të datës 23.09.2019, ka deklaruar dhe e ka përshkruar gjithë rrjedhën e ngjarjes se si ka shkuar takimi me të akuzuarin S B dhe se dëshmitari i kishte thënë se i kishte sjellë dy zarfa me nga 1000 Euro, njërin për gjyqtarin S B dhe njërin për të akuzuarin S B dhe se ky i fundit i ka marrë zarfat i ka palosur dhe i ka futur ne xhep, ku më pas edhe është arrestuar nga policia. Ndërsa gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se i akuzuari S B nuk e ka ditur se ka pasur para në zarf dhe se dëshmitari nuk i ka treguar me friken se nuk do ti merrte, por i ka thënë së është ftesë familjare për dasmë. Ai po ashtu gjatë ballafaqimit në seancën e shqyrtimit gjyqësor nga KTGJ me CD, ai ka deklaruar se shumica e ngjarjeve apo fjalëve të tij kanë qenë të trilluara për arsye që me sjelle S në atë takim, që ai mos me marr vesh ose mos me dyshua se për çka e kam ftuar unë në takim, pasi që bashkëpunimi me policinë që e kam pas ka qenë ky. Me tutje ka shtuar se pas asaj dite është ndier i kërcënuar dhe për këtë rast ka njoftuar policinë dhe prokurorin speciale dhe te gjitha detajet i ka dhënë në atë deklaratë. Sa i përket S B, dëshmitari ka deklaruar se e ka quajtur “dajë” sepse ka qenë i katundit prej nga edhe i ka pasur daj të dëshmitari. Dhe ne fund të deklaramit të tij ka shtuar se S B i kërkoje falje që e kam shti në kësi far kombinime dhe në dëmin që e kam shkaktuar.

3.1.2 Dëshmitari V Sh, në dëshminë e dhënë në shqyrtimet gjyqësore të datave: 06.05.2022, 06.06.2022, 05.07.2022, 06.07.2022, 07.09.2022, 05.10.2022, 06.10.2022, fillimisht ka deklaruar se në policinë e Kosovës është punësuar qe nga viti 2004, ku ka qenë në njësinë patrulluese ne stacionin Policor Jugu, e pastaj rreth 6 vite ka punuar ne hetimet rajonale në sektorin e veprave penale kundër pasurisë, konkretisht në njësinë e grabitjeve dhe vjedhjeve të rënda, dhe tani mbi 8 vite është në DHKEK si hetues - si mbikëqyrës-rreshter. Dëshmitari tutje

ka deklaruar se ka qene bartës i lendes që te hetoje rastin ndaj të akuzuarit S B, ku është caktuar nga eproret e tij, ku i kane asistuar dy koleget e tij F M- toger dhe B Sh- hetues i Krimeve Ekonomike. Dëshmitari ka deklaruar se procedura ndaj të akuzuarit S B ka filluar pas raportimit te bere nga ana e ankuesit F Z, i cili ankesën e ka deponuar ne Drejtorinë e Krimeve Ekonomike, pastaj janë autorizuar që të vazhdojnë hetimet bazuar ne informatat e deponuara nga ankuesi F Z, ku deklaratën e parë nga ankuesi e kane marrë dëshmitari V së bashku me policet Fidan Maliqi dhe B Sh, ku i janë lexuar te drejtat dëshmitarit apo ankuesit i cili ka raportuar rastin në polici, pastaj është zhvilluar intervista dhe në fund i është dhënë deklarata që ta lexoje dhe i njëjti është pajtuar me atë që ka thënë dhe të njëjtën e ka nënshkruar me vullnetin e tij të lire. Tutje ka shtuar se ankuesi F Z, ka dhënë ndoshta më shumë se 4 deklarata, se ato mbi 4 deklarata nuk kanë të bëjnë vetëm me çështjen e gjyqtareve të Pejës, por edhe ndaj ankesave të gjyqtarëve të tjerë që ka pasur siç është ndaj gjyqtarit të Apelit, pastaj gjyqtarit të Mitrovicës si dhe disa ankesa tjera që ka pasur e që janë iniciuar si lëndë të veçanta. Dëshmitari ka deklaruar se para këtij rasti nuk e ka njohur me parë as ankuesin F Z e as të akuzuarin S B dhe se fillimisht hetimi ka filluar pasi ankuesi F Z, kishte ardhur që te raportoje një lëndë ndaj një gjyqtari të Apelit, ku emri nuk i kujtohej, ku sipas tij kanë kërkuar rreth 200 mijë euro me qëllim që të ja zbresin apo të ja heqin vuajtjen e dënimit që ka pasur për një rast ankuesi F Z, dhe te ia kthejnë në pikën zero hetimin, dhe gjatë vazhdës se hetimeve ndër tjera e ka potencuar edhe lëndën ndaj S B, si dhe ndaj një gjyqtari tjetër të Pejës që emri nuk i kujtohej, ku ka deklaruar se këta dy persona i kanë kërkuar para me qëllim që ti ndihmojnë në procedurën gjyqësore vëllait të F Z, ju kishte dhënë një shumë rreth 4000 euro me qëllim që ti ndihmojnë në procedurën gjyqësore ndaj vëllait të tij për veprën penale Kontrabandim me migrantë, dhe se sipas tij ka pasur me i dhënë edhe 2000 euro si rezultat i kësaj marrëveshje. Dhe në kohën kur ka dhënë deklaratën dëshmitari F Z, ka thënë se ata janë të gatshëm që ti marrin këto para pasi që ai ka komunikim me ata, po ashtu ka përmendur edhe emra të tjerë por saktë nuk i kujtoheshin, njëri ka qenë nga Istogu, ndërsa rasti tjetër ka qenë për gjyqtarin R I si dhe ndaj një zyrtari policor B G. Dëshmitari V Sh ka deklaruar se deklarata e deponuar në polici së bashku me një shënim zyrtarë është dërguar në Prokurori Speciale tek prokurori i lëndës B I, pastaj me rekomandimet e tij fillimisht është ngritur kallëzim penal për dy gjyqtarët në fjalë dhe është bërë kërkesë nga ana e tyre për masë të fshehtë të simulimit për të cilat edhe është lëshuar urdhëresë nga ana e gjykatës dhe ka filluar implementimi i kësaj urdhërese, ku kjo procedurë e njëjtë është zhvilluar edhe për zyrtaret e tjerë. Tutje dëshmitari V Sh ka deklaruar se gjatë asaj kohe sa ka qene duke hetuar rastin, ankuesi F Z, është arrestuar nga policia e Kosovës pasi që ai ka pasur një aktgjykim të formës së prere nga Gjykata Themelore ne Mitrovice që është dashur të shkojë në vuajtje të dënimit, dhe sa i kujtohet dëshmitari ka shkuar në Burgun e Dubraves dhe është liruar të njëjtën dite që është arrestuar apo të nesërmen

nuk i kujtohet dhe ne pyetjen e prokurores se; “*gjatë hetimit të rasteve që i ka raportuar F Z, a i keni premtuar ju ndonjëherë F Z që do ti ndihmonit në çështjen që ai kishte pasur me ligjin, apo a i keni ndihmuar ju që të lirohet nga arrestimi në çfarëdo mënyre*”, dëshmitari është përgjigjur se: “*asnjëherë nuk i ka premtuar F Z që do ti ndihmonte në çështjen që ai kishte pasur me ligjin dhe asnjëherë nuk i ka ndihmuar që ai të lirohej nga arrestimi dhe këtë ka theksuar se e deklaroj me përgjegjësi penale dhe morale*”. Po ashtu ka deklaruar se sa është ne dijeni dëshmitari, askush nga hetuesit apo nga ana e prokurorit nuk i ka ndihmuar dëshmitarit F Z, që të lirohet ne te njëjtën dite që është arrestuar apo te nesërmen. Ndërsa sa i përket kontaktit me te pas lirimit, dëshmitari deklaron se po kam kontaktuar me dëshmitarin F Z pas lirimit, por nuk e di saktë atë ditë apo gjatë javës dhe 95% te rasteve që ka pasur kontakte me te, F Z ka qene ai që e ka kontaktuar, dhe ka shtuar se dua ta ritheksojë se as para e as pas lirimit në asnjë formë nuk e kam kontaktuar për asgjë dëshmitarin F Z. Dëshmitari V Sh me tutje ka përshkruar rrjedhën sa i përket simulimit te veprës penale e cila është bere gjatë hetimit ndaj të akuzuarit S B, ku ka deklaruar se aplikimi i masës pas sigurimit të urdhëresës nga ana e Gjykatës në Prishtinë, është realizuar në bashkëpunim me njësinë relevante, përkatësisht asistencës teknike siç janë vendosja e pajisjeve, incizimi i kontakteve dhe bisedave, ndërsa zhvillimi i hetimeve është bërë nga ana e tyre. Inicimi i takimit dëshmitari V Sh ka deklaruar se është bere nga vet ankuesi F Z, i cili ka komunikuar me S qoftë përmes viberit apo formave te tjera dhe se sipas tij qëllimi i këtij takimi ishte që ti japë edhe shumën e mbetur prej 2000 euro gjyqtarit S B, dhe gjyqtarit tjetër që emri i tij nuk i kujtohej, e cila shumë ka pasur që ti jepet për ndihmën e mëhershme që është bërë nga ana e gjyqtarëve ndaj vëllait të tij, dhe ka mbet që të takohen në ditën kritike, i njëjti kishte ardhur dhe i kishte informuar dhe pastaj ju kishin vendosur pajisjet për aplikimin e masave të fshehta e cila është zbatuar në tërësi në ditën e aplikimit, i ishin dhënë paratë për simulimin e veprës penale në shumën prej 2000 euro, nga fondi i Policisë së Kosovës, të cilat paraprakisht ishin regjistruar me numër serik, pastaj ishin vendosur pajisjet teknike të masave të fshehta për regjistrimin e bisedës, ku ndër tjera është biseduar që kjo masë duhet të implementohet pikërisht në atë së çka ai ka deklaruar në polici se ke thënë kështu dhe duhet të veprohet kështu. Dëshmitari ka shtuar se i kane thënë që të bisedojë dhe të diskutojë me gjyqtarin në fjalë për ankesën që e ka deponuar në polici dhe ka raportuar që i ka mbetur edhe 2000 euro që të ja jap si rezultat i ndihmës që e kanë bërë më herët, pra është fjala për gjyqtarët. Dëshmitari V Sh, ka theksuar se duhet të kihet parasysh fakti që ata nuk e kishin urdhëruar e as obliguar që të flasë çka thonë ata, që të ndahet kjo, ata e kishin sugjeruar apo rekomanduar që biseda që do të zhvillohet me gjyqtarin në fjalë duhet të zhvillohet sipas ankesës që kishte deponuar ankuesi, për me sqaru atë që ka thënë para tyre, e jo për naj borxh që e ka anej a knej, dhe ka shtuar se çështjen kur e thoshte për borxh ka sqaruar se këtë e ka marrë si shembull që mos të dedikohet diçka tjetër por vetëm në atë çka ka

deklaru. Dhe tutje dëshmitari V Sh ka shtuar se ankuesi F Z, kishte vazhduar për në Pejë, ku ishte takuar në një restorant që nuk i kujtohej emri, me gjyqtarin S B, ndërsa gjyqtari tjetër që kishin menduar që do të vijë nuk kishte ardhur dhe çdo herë i referohet deklaratës së vet dëshmitarit F Z, i cili kishte deklaruar se janë dy gjyqtarë. Dhe aty në atë restorant kishin drekuar dhe kishin biseduar në mes vete, (dëshmitari ka deklaruar se nuk kisha dashur që ti referohem bisedës që çka kanë biseduar meqë janë të inqizuara), pastaj kishin dalur nga lokali për në veturën e F Z, dhe aty nga vetura ku i kishin pasur mjetet (paratë e simulimit) F Zia kishte dhënë gjyqtarit S B dhe pas marrjes së atyre të hollave gjyqtari kishte zbritur nga vetura dhe dikund rreth 50-100 metra ishte ndalur nga Policia e Kosovës dhe ishte arrestuar gjyqtari. Dëshmitari thekson se ai atë ditë në vendin e ngjarjes nuk ka qenë prezent gjatë arrestimit, por pas arrestimit ka shkuar në vendin ku është ndaluar, dhe bisedat kanë qenë direkt dhe çka është bisedu mes tyre është dëgju nga ana e tyre dhe kane qenë të informuar drejtpërdrejtë edhe në kohën kur ka zbrit nga vetura gjyqtari dhe pas kësaj të gjitha dëshmitë që ishin nxjerrë sipas kësaj urdhërese ishin dorëzuar dhe deponuar në prokurorinë speciale. Dëshmitari tutje ka shtuar se gjatë hetimit me përgjegjësi morale dhe penale ka deklaruar se asnjëherë në asnjë rrethanë nuk kishte kërcënuar as përdorur ndonjë element kërcënimi ndaj dëshmitarit F Z. Ndërsa sa i përket intervistimit të ankuesit F Z, pas vuajtjes së dënimit në qendrën korrektuese në Dubrave, dëshmitari V Sh ka deklaruar se ka kontaktuar, nuk i kujtohej në një rast apo dy, dhe ka sqaruar se ai e ka kontaktuar dhe gjatë atyre bisedave telefonike i ka shfaqur disa ankesa ku si rezultat i tyre janë iniciuar edhe raste të reja e që ka konsideruar se nuk kanë të bëjnë më çështjen që ishte duke dëshmuar në shqyrtim gjyqësor. Ndërsa sa i përket vazhdës së hetimit pasi që ankuesi ishte në vuajtje të dënimit në burgun e Dubraves dhe pyetjes se mbrojtësit se “ *nëse statusi i tij nga i lirë në person të izoluar do të kishte ndonjë ndikim në rastet që këta i kishin në trajtim, kuptohet në hetim apo veprimet hetimore që këta kishin planifikuar ti ndërmerrenin si hetues*”, dëshmitari është përgjigjur se “ *nuk di as çfarë përgjigje të jap, për faktin se është shumë e qartë se sikur ai të ishte në vuajtje të dënimit ai do të na pengonte në hetimin e atij rasti, mirëpo nuk do të thotë që më vuajtjen e dënimit të dëshmitarit nuk do të thotë se neve na u kishin dëmtuar lëndët ose diçka*” Me tutje ka shtuar se është intervistuar nga ana e tij në qendrën e mbajtjes në Dubravë, i cili ka shfaqur shqetësime se familja e tij në një rast ndjehet e kërcënuar për faktin se i kanë shkuar disa persona në shtëpi dhe i kishin thënë sipas tij që gjyqtarin R I e keni qar në burg, ndërsa rasti i dytë që është iniciuar lëndë dhe është zhvilluar hetim është ankesa e vet F Z, i cili kishte deklaruar se i kishin shkuar dy persona, dhe sipas tij ishin persona të lartë në politike dhe i kishin thënë se duhet me i tërheq të gjitha deklaratat që i kishte dhënë në polici, pra e kishte fjalën që dëshmitarit F Z i kishin shku këta persona në burg.

3.1.3 Dëshmitarja T Th, në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 08.09.2022, fillimisht ka deklaruar se jeton në Gjermani, që nga viti 1999, me burrin dhe katër fëmijët e saj, të cilët punojnë dhe veprojnë në Gjermani. Tutje ka shtuar se të akuzuarin S B e ka burrë të motrës, ndërsa sa i përket parave në vlerë prej 10.000.00 Euro që janë sekuestruar me rastin e bastisjes së shtëpisë së të akuzuarit S, deklaroi se ato para janë të saj dhe se ia kishte lënë motrës së saj kur kishte ardhur në pushime verës në muajin Gusht, me qëllim që deri në pushimin tjetër që e kishte pasur në Nëntor, t'i paguante mjeshtërit që kishin pasur me rregulluar murin e shtëpisë më rrethoja (tela) dhe për të rregulluar një pjesë të ballkonit. Dëshmitarja ka deklaruar se për këto para ka edhe faturat për tërheqjen e tyre dhe ka shtuar se ka ndodhë edhe herave të tjera që të ketë lënë para tek motra e saj. Dhe se këto para kur ia ka lënë motrës së saj Ze (bashkëshortesë së të akuzuarit S), e cila i ka mbështjellë në zarf dhe e ka shkruar emrin T Th. Ndërsa sa i përket faktit se pse nuk i ka lajmëruar paratë kur ka mbërritur në aeroport ka deklaruar se ato para nuk e kanë kaluar vlerën prej 10.000.00 Euro, dhe se vajza e saj i ka pas 6.200 Euro ndërsa T Th 9.800 Euro, prandaj edhe nuk i kanë lajmëruar në aeroport, dhe me tutje ka shtuar se këto para i kanë fituar me djersën e tyre dhe mezi ka pritur që të dëshmojë në lidhje me to.

3.1.4 Dëshmitarja Z Th, në shqyrtimin gjyqësor të datës 08.09.2022, fillimisht ka deklaruar se të akuzuarin S Be ka bashkëshort, si shkollim ka të kryer gjimnazin, është amvise. Paratë që janë gjendur në banesën e saj me datën 19.09.2019, gjatë bastisjes, kanë qenë të motrës së saj T, të cilat kanë qenë të vendosura në një zarf, e cila në prezencën e motrës së saj në zarf ka shënuar emrin T Th. Paratë atë ditë që janë sekuestruar ka deklaruar se kanë qenë në dhomën e Ve - djalit të saj dhe kanë qenë të ndara në dy vende nga 5000 Euro dhe të gjitha kanë qenë nga 50 Euro. Për këto para ka theksuar se nuk ka qenë në dijeni i akuzuarit S. Këto para motra e saj ia kishte lënë kur kishte ardhur në Gusht për pushime për shkak se në shtëpinë e saj ishin duke u zhvilluar disa punime dhe se në rast se ajo nuk mund të vinte deri në Nëntor, me këto para ata të paguanin mjeshtret për punën e kryer. Dëshmitarja tutje ka shtuar se atë ditë gjatë bastisjes në shtëpinë e saj është gjetur edhe një armë të cilën vet ajo ia ka dorëzuar policisë, i kishte thënë djalit të saj V, që të merr armën e cila gjendej në çantën e saj në dhomën e S dhe të ia dorëzonte policisë. Me tutje ka shtuar se kjo armë ishte e kunatit të saj Samiut - vëllait të akuzuarit S, i cili jeton në Pejë, me familjen e tij dhe se ai ia kishte lënë 2-3 ditë para bastisjes, ngase ishte duke shkuar në Rozhajë, dhe kishte ardhur tek banesa e të akuzuarit S dhe se në banesë ishte vetëm dëshmitarja Z dhe se Samiu i kishte thënë se po ta lë këtë armë se jam duke shkruar në Rozhajë dhe do të vinte ta merrte atë ditë apo të nesërmen dhe se për këtë gjë nuk i kishte treguar askujt që kunati i saj i kishte lënë armën në shtëpi, pasi që ia kishte lënë në besë dhe ai i kishte kërkuar ashtu, madje shton se as bashkëshorti i saj S nuk ishte në dijeni për këtë fakt. Ajo ka shtuar se nuk e

kishte ditur nëse arma ishte me leje apo jo. Dëshmitarja tutje ka shtuar se pas ditës kritike e kishte njoftuar kunatin e saj S, për rastin që kishte ndodhur dhe se arma i ishte marrë nga policia, dhe se kunati i saj kishte dashur që të shkonte në polici që të deklaronte që arma është tije, mirëpo nuk e kishte lënë këtu dëshmitarja Z Th, për arsye se ishte arrestuar i akuzuari S dhe mos të ndodhte ndonjë gjë edhe me të, pasi që ishin familje dhe sikur ti ndodhte diçka S sikur S do të ishte e njëjta gjë. Tutje ka shtuar se me S nuk ka biseduar ndonjëherë ne lidhje me armët dhe në pyetjen e gjykatës së “ *meqë po thuani që edhe për paratë edhe armen që nuk e ka ditur S dhe meqë ka qenë gjyqtar, a i keni mbajtur çdo here kësi fshehtësi S, pse vendose me lënë paratë në dhomën e V e armen ne dhomën e juaj te S*”, dëshmitarja Z Th nuk ka dashur që të përgjigjet. Dhe në fund ka deklaruar se paratë janë të motrës së saj dhe kërkon që të njëjtat ti kthehen.

### 3.2 Provat materiale

3.2.1. Nga leximi i Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë – Departamenti për Krime të Rënda me shenjen PRK.P.nr. .. i datës 05.01.2016, i plotfuqishëm me datë 15.02.2016, gjykata ka vërtetuar faktin se i akuzuari S B, si kryetar i trupit gjykues kishte vendosur ne çështjen penale ndaj M Z – vëllait të dëshmitarit F Z, i akuzuar sipas Aktakuzës me nr. PP nr. 100/2009 të dt. 04.03.2015, për dy vepra penale Kontrabandim me migrantë nga neni 138 par. 1 të KPRK-së, në bazë të cilit në atë çështje i akuzuari M Z, ishte shpallur fajtor për veprat penale për të cilat akuzohej dhe ishte dënuar me dënim me kusht në kohëzgjatje prej 3 (tre) vitesh me kusht në periudhën kohore për dy vite, dhe me gjobë prej 1000 (një mijë) euro.

3.2.2. Nga leximi i Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Pejë, Departamenti për Krime të Renda me shenjen DKR.PP.nr..., i datës 27.06.2014, gjykata ka vërtetuar faktin se i akuzuari S B, si gjyqtar i procedurës paraprak, në çështjen penale ndaj të pandehurit M Z, i dyshuar për kryerjen e dy veprave penale Kontrabandimi me migrantë nga neni 138 par. 1 të KPRK-së, kishte refuzuar kërkesën e prokurorisë për caktimin e Paraburgimit ndaj M Z, dhe ndaj të njëjtit kishte caktuar Masën e Dorëzarisë në lartësi prej 3000(tre mije)Euro.

3.2.3. Nga shikimi i CD-se së datës 19.09.2019, fotoinqizime 030-V-2019, gjykata ka vërtetuar faktin se i akuzuari S B, ishte takuar më dëshmitarin F Z, ne lokalit e quajtur “Toni” ne Pejë, i cili gjendej ne afërsi të banesës së të akuzuarit S B, dikund rreth orës 16;00, të cilët kishin drekuar së bashku dhe kishin zhvilluar bisedë mes tyre lidhur me marrjen e 2000 Eurove .



3.2.4. Nga shikimi i CD-se video ne automjet dhe trup, gjykata ka vërtetuar faktin se i akuzuari S B, pas përfundimit te drekës me dëshmitarin F Z, i njëjti kishte shkuar ne veturën e dëshmitarit dhe ishte ulur ne anën e pasagjerit, dhe nga dëshmitari kishte pranuar zarfin me para në vlerë prej 2000 Euro.

3.2.5. Nga shikimi i Videos se kontrollit ne trup, gjykata ka vërtetuar faktin se i akuzuari S B, pas pranimit të zarfit me para në vlere prej 2000 Eurove nga dëshmitari F Z, i njëjti arrestohet nga policia dhe gjatë kontrollit ne xhepin e brendshme te setrës se tij, i është gjetur zarfi me para ne vlere prej 2000 Eurove.

3.2.6. Nga leximi i Procesverbalit mbi kontrollin e personit dhe shtëpisë, lokaleve dhe pronës me shenjën 2019 KE 372, i datës 19.09.2019, gjykata ka vërtetuar faktin se ne banesën e të akuzuarit S B, përkatësisht ne dhomën e tij të fjetjes, është gjetur një revole e tipit “ Zaza Mini” e kalibrit 8 mm, T592372, e cila është konfiskuar nga policia e Stacionit policor në Pejë, së bashku me një karikator dhe 10 fishekë të kalibrit 10 mm. Po ashtu janë gjetur edhe disa shkresa, aktgjykime, procesverbale të evidentuara në vërtetimin mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve. Po ashtu në dhomën e V -djalit të akuzuarit S B, janë gjetur 10.000 Euro, të gjitha nga 50 uro (20x50) të cilat nga kjo dhomë, znj. Z Th B- bashkëshortja e të akuzuarit, i ka sjellë në dhomën e ditës. Po ashtu është bastisur edhe automjeti Pasat me targa 03-827-AK, në të cilën nuk është gjetur asgjë e dyshimtë.

3.2.7. Nga leximi i Foto dokumentacionit, përkatësisht foto albumin e vendit të ngjarjes, i datës 19.09.2019, gjykata ka vërtetuar faktin se në banesën e të akuzuarit S B, është gjetur shuma e parave ne vlere prej 10.000 Euro, të gjitha nga 50 Euro, të cilat kane qenë të mbështjella në një zarf, me mbishkrimin T Th. Po ashtu ne dhomën e gjumit(që i korrespondonte anës perëndimore) është gjetur edhe revolja e tipit “ Zaza Mini” e kalibrit 8 mm, T592372, si dhe një karikator me 10 fishekë të kalibrit 6.35 mm.

3.2.8. Nga leximi i Raportit të vëzhgimit, të datës 19.09.2019, gjykata ka vërtetuar faktin se i akuzuari S B, dikund rreth orës 15:58 minuta, me veturën e tij Pasat, ngjyrë vishnje, me targa të regjistrimit 03-827-AK, vjen nga rruga kryesore dhe hyn ne hyrjen e rrugës me tunel ne drejtim të Prokurorisë Themelore në Pejë, e parkon veturën dhe vazhdon këmbë ne drejtim të rrugës kryesore duke përdorur një rrugë dytësore këmbë. I njëjti hyn në restorantin “Toni” dhe ulet në tavolinë me një person mashkull- i cili është dëshmitari F Z, i cili vje me veturën Mercedes ML, ngjyrë e bardhë, me targa të regjistrimit 03-980-FJ, i cili kishte hyrë më parë në restorantin

“Toni”. Dëshmitari F Z, ngritët nga tavolina ku del nga restoranti dhe ia liron rrugën dikujt me veturë, dhe më pas kthehet prape ne restorant dhe ulet me të akuzuarin S B dhe porosisin ushqim. Pas përfundimit të drekës, dëshmitari kërkon faturën dhe bënë pagesën dhe bashkë më të akuzuarin S, dalin nga restorant “Toni”. Dëshmitari F Z hyn ne veturën e tij Mercedes Ml, ngjyrë të bardhë, po ashtu edhe i akuzuari S B, hyn në veturë në ulësen e pasagjerit dhe qëndron për pak kohë dhe bisedojnë, gjatë kohës së bisedës dëshmitari i jep një pliko të bardhë të akuzuarit S B, dhe më pas i njëjti del nga vetura dhe niset në këmbë drejt veturës së tij, ku më pas arrestohet nga policia.

3.2.9. Nga leximi i listës së armëve dhe municionit të konfiskuar, me numër 2019-DA-1888, të datës 19.09.2019, gjykata ka vërtetuar faktin se, në banesën e të akuzuarit S B, gjatë bastisjes është konfiskuar një revole e tipit “Zaza Mini”, e kalibrit 8 mm, me numër serik: T592379, një karikator dhe 10 fishekë të kalibrit 6.35 mm.

3.2.10. Nga leximi i Raportit të ekspertimit të AKF-së, me numër 2019-0379, për ekspertimin e telefonit të akuzuarit S B, i datës 13.12.2019, gjykata ka vërtetuar faktin se PSRK sipas urdhëresës me numër PPS.nr.52/2019 të datës 26.08.2019, ka kërkuar nga AKF që të bëhet ekzaminimi i pajisjeve elektronike dhe nxjerrjen e të dhënave duke përfshirë edhe të dhënat nga rrjetet sociale të instaluar në telefonin e të akuzuarit S B. AKF pas ekzaminimit të telefonit të akuzuarit S, ne konstatimin dhe mendimin përfundimtar ka konstatuar se nga telefoni Samsung modeli SM-A600G/DS, gjatë procesit të ekzaminimit kanë arritur të nxirren thirrjet, kontaktet, SMS mesazhe, foto imazhe, audio dhe video fajlla. Ne telefon ka pasur të instaluar aplikacionin Viber por nuk ka qene e mundur që të nxirren komunikimet, ndërsa nga dy SIM Kartela Vala dhe Ipko kanë arritur të nxirren thirrjet, kontaktet dhe mesazhet (një mesazh ku shihet se dëshmitari F Z i kishte shkruar të akuzuarit S B “*mirëmëngjesi zotri i nderuam a jeni mire si po kaloni a muj pushove hiq kur juve ju konvenon me u taku unë jamë gati ju Faleminderit shume respekt për ju F*” si dhe te dhënat standarde që përmban një SIM karte si numri serik, rrejtja që i përket etj.

3.2.11. Nga leximi i Raportit njoftues lidhur me ekzaminimin e telefonit mobil, me numër 2019-KE372, i datës 23.12.2019, gjykata ka vërtetuar faktin se sipas vendimit te PSRK-së, të akuzuarit S Bi është ekzaminuar telefoni mobil i tipit “Samsung”, ngjyrë e zezë, me numër të IMEI-1:3579310991274941 dhe IMEI-2:357932099127949, ku pas ekzaminimit të njëjtit është bërë analizimi i dëshmimeve që kanë rrjedh si rezultat i këtij ekzaminimi, me c’rast është gjetur një mesazh i dërguar nga F Z në telefonin e të dyshuarit S, me shkrimin “*mirëmëngjesi zotri i*

*nderuam a jeni mire si po kaloni a muj pushove hiq kur juve ju konvenon me u taku unë jamë gati ju Faleminderit shume respekt për ju F". Gjatë ekzaminimit të telefonit nuk është gjetur ndonjë element inkriminues prove apo ndonjë dëshmi tjetër. Ne telefon ka të instaluar edhe aplikacionin Viber, por pajisjet e AKF-se nuk kane arritur që të nxjerrin komunikimet.*

3.2.12. Nga leximi i Raportit të këqyrjes se vendit të ngjarjes, me numër 2019-KE372, i datës 01.10.2019, i përpiluar nga B T, gjykata ka vërtetuar faktin se me datë 19.09.2019 rreth orës 18;20 minuta në zyrat e DHKE ne Pejë, kishte filluar incizimi me kamere gjatë kontrollit të akuzuarit S B, dhe pas përfundimit të kontrollimit janë evidentuar dëshmitë; dy pliko letre me ngjyrë të bardhë në të cilën kishte para ne vlere prej 2000 Euro (19x100 dhe 2x50) Euro, si dhe një telefon "Samsung" me ngjyrë te zeze, letërnjoftimi ne emër te akuzuarit S B, patentë shoferi ne emër te akuzuarit S B, kartelet bankare TEB ne emër te akuzuarit S B, kartelë zyrtare e gjykatës me numër KGJK-2735, kartelet e veteranit të UCK-se ne emër te akuzuarit S B, letra të vogla me shënime te ndryshme, si dhe para ne vlere prej 80.30 Euro (1x50, 1x20, 1x5, 1x5 1x0.20 dhe 1x0.10) si dhe një palë syze.

3.2.13. Nga leximi i Raportit të ekspertimit financiar, me numër 2019-KE-372, i datës 26.12.2019, gjykata ka vërtetuar faktin se me analizën financiare janë shqyrtuar të dhënat financiare përkatësisht llogaritë bankare të akuzuarit S B si dhe familjareve të tij, ku ne periudhën kohore prej 01.01.2018 deri me 01.10.2019, bilanci fillestar ka qene 1,695.07 Euro, ndërsa bilanci përfundimtare ka qene 5,512.22Euro. Po ashtu ne raportin e ekspertimit janë specifikuar të gjitha pasurit e luajtshme dhe të paluajtshme që janë ne emër të akuzuarit S B.

3.2.14. Nga leximi i Raportit të ekspertimit të AKF-së me numër referues AKF/2020-0463/2020-416, i datës 18.05.2020, gjykata ka vërtetuar faktin se në banesën e të akuzuarit S B është gjetur pistoleta e gazit e tipit "Zaza Mini" e kalibrit 8 mm gaz, me numër serik: T-592372, e cila është e ri dizajnuar(e punuar me dorë duke ju vendosur një tytë me vjaska) dhe në këtë mënyrë arma është bërë armë e zjarrit që të shkrepë fishekë të kalibrit 6.35x15 mm me mbushje të barotit, dhe ka qenë funksionale. Një karikator i zbrazët i dizajnuar për këtë pistoletë me kapacitet prej 6 fishekësh të kalibrit 8 mm, dhe 10 fishekë të kalibrit 6.35x15 mm.

3.2.15. Nga leximi i Deklaratës së dëshmitarit F Z, të dhënë pranë Policisë së Kosovës NJH/KEK në Prishtinë, me datën 09.09.2019, gjykata ka vërtetuar faktin se dëshmitari F Z, përpos tjerash kishte deklaruar se: ...përveç rasteve që kishte përmendur ne polici, i kishte ndodhur edhe një rast në Gjykatën Themelore në Pejë, në të cilin rast kishte qenë i involvuar vëllai i tij M Z, i cili

ishte arrestuar nga policia për veprën penale Trafikim me qenie njerëzore, dhe gjyqtar i këtij rasti kishte qene i akuzuari S B, ku përmes avokatit O B, i akuzuari S B i kishte kërkuar që të takohet me këtu dëshmitarin Florim. Ai ka pohuar se është takuar me të akuzuarin S B- i cili ishte gjyqtar i procedurës paraprake dhe se ky i fundit i kishte thënë se për veprën penale për te cilën ngarkohen vëllai i tij M Z, të kontaktoj gjyqtarin S B, për faktin se ishte gjyqtar i trupit gjykues. Dhe dëshmitari kishte vepruar ashtu siç i kishte thënë i akuzuari S, dhe kishte shkuar në zyrën e S, kishin biseduar rreth çështjes dhe gjyqtari S B i kishte thënë se duhet si procedurë ti lë dorëzani 3000 Euro për vëllain e tij, ndërsa këtë çështje e kryejnë dhe si shpërblim duhet të ua jap shumën prej 6000 Euro të cilat duhet ti ndajë edhe me gjyqtarin-këtu të akuzuarin S B dhe prokurorin e lendes të cilit nuk ia dinte emrin. Dëshmitari ka deklaruar se kishte pranuar që t'ua jap mjetet, mirëpo atë ditë nuk i kishte pasur po ju kishte thënë që ua sjelle nesër vetëm lirojnë vëllain tim. Ashtu që gjyqtari S B dhe S B kane vendosur ne favor të vëllait te tij dhe e kane liruar në procedurë te rregullt, ndërsa të nesërmen i kishte dhënë 2000 Euro gjyqtarit S B, të cilit ia kishte dërguar në zyre ne Pejë. Tutje ka shtuar se S nuk ka qenë i kënaqur që nuk ia kam dërguar të gjitha mjetet dhe e kishte pyetur se kur do të ia jap pjesën tjetër prej 4000Euro, dhe dëshmitari i ishte përgjigjur se nuk i kishte momentalisht mirëpo i kishte thënë se nesër do ti gjej huazim edhe 2000Euro dhe do ti ia sjelltë, ndërsa pjesën tjetër prej 2000 Euro do të ia jepte sapo të përfundonte procedura dhe te tërhiqet dorëzania ndaj vëllait të tij. Procedura ndaj vëllait të tij ishte kryer sipas marrëveshjes dhe ai kishte arritur ti tërheq mjetet e dorëzanisë, mirëpo pjesën e mbetur prej 2000Euro që kishte për të ia dhënë gjyqtarit S B, nuk ia kishte dhënë më asnjëherë dhe se ai kishte deklaruar se gjyqtari vazhdimisht ia kishte kërkuar këto mjete dhe edhe atë ditë përderisa ishte duke dhënë dëshmi, kishte thënë se është në gjendje ti marr për faktin se ai i kishte thënë se unë ta kam kryer punën për vëllain ashtu siç ka qenë marrëveshja.

3.2.16. Nga leximi Deklaratës së dëshmitarit F Z, të dhënë pranë Policisë së Kosovës NJN/KEK-Prishtinë, më datë 23.09.2019, gjykata ka vërtetuar faktin se dëshmitari F Z, pas deklaratës që kishte dhënë me datë 09.09.2019, kishte kontaktuar me gjyqtarin - këtu të akuzuarin S B si dhe me gjyqtarin S B. Me gjyqtarin S B, ishin takuar edhe fizikisht ku kishin biseduar për obligimin e mbetur para dy apo tri viteve dhe i kishte thënë se jam i gatshëm ta paguajë, dhe i akuzuari S i kishte thënë se me konvenon se ishte duke planifikuar që të shkonte në pushim për vikend me familje, dhe dëshmitari i kishte thënë se kishte shitur një pronë dhe posa të ia qitnin paratë e tokës pas 2-3 dite, do të ia jepte të akuzuarit S. I akuzuari kishte pranuar dhe i kishte thënë se do të jemi në kontakt dhe se do të dalin një ditë në dark pas orarit të punës pas orës 16:00, dhe se kishte dëshirë që me qenë prezent edhe gjyqtari S B, dhe dëshmitari F Z ishte pajtuar më këtë çështje dhe ashtu e kishin lënë. Gjate vikendit e kishte kontaktuar të akuzuarin S, i cili i kishte

thënë se është në pushim ne Shëngjin dhe pasi ishte kthyer ishin dëgjuar 2-3 here përmes telefonit me të akuzuarin S dhe me gjyqtarin S B, ndërsa ditën e enjte ishin dëgjuar përmes telefonit ku kishin lënë takim në ora 16:00 tek restorant “Toni” në Pejë. Aty kishte shkuar i akuzuari S B, dhe e kishte njoftuar dëshmitarin se F Z, se gjyqtari S B i kishte bërë të fala dhe se nuk mund të vinte ne takim se ishte i sëmurë me grip. Gjatë bisedës e sipër kishin porositur ushqim dhe dëshmitari F Z e kishte njoftuar të akuzuarin S se ia kishte sjellë të hollat për të dhe për S, sipas marrëveshjes që e kishin pasur të dyve nga 1000€uro dhe se nëse nuk iu mjaftojnë dëshmitari i kishte thënë se iu jap tjera herë edhe sa të ketë nevojë. Dëshmitari F Z, i kishte treguar që paratë ndodheshin në veturë, dhe pas përfundimit të drekës i njëjti me shpejtësi të madhe kishte shkuar të vetura e dëshmitarit F dhe dëshmitari i kishte treguar se janë dy zarfa me nga 1000€uro, dhe i akuzuari e kishte pyetur se a i ke numërua, dhe dëshmitari i kishte thënë se po i kam numëruar dhe nëse nuk beson numëroj prape. I akuzuari S pas kësaj i kishte marrë zarfat i kishte bërë dyfish dhe i kishte shti ne xhep dhe e kishte falënderua dëshmitarin duke i thënë se shihemi prape dhe i kishte thënë se ta kryeje unë të S dhe se takohemi edhe ndonjë here tjetër dhe e kishte marrë obligim që njëren pjesë d.m.th. prej 1000€uro do të ja jap ai gjyqtarit S B. Tutje ka shtuar se është ndier më i lire pas arrestimit të akuzuarit S B, pasi që nuk është kërcënuar direkt, mirëpo ka pasur thirrje nga mbrojtësi i të akuzuarit S, av.Gëzim Kollcaku, i cili i kishte thënë a po vjen se ki më dhënë një deklaratë dhe me bisedua diçka me të, mirëpo dëshmitari i kishte thënë se nuk kam kohë se jam në Shqipëri dhe takohemi tjetër herë. Në fund të deklaratës së tij ka shtuar se ka njohuri se gjyqtari-këtu i akuzuarit S B, asnjë lëndë nuk e kryen pa pare, pasi që i njëjti e kishte lutur që të hyj si ndërmjetësues në një rast ku i dyshuar kishte qenë M M dhe gjyqtari S B ia kishte dërguar bashkëpunëtorin e tij me emrin V, mbiemri i të cilit nuk i kujtohej, dhe i kishte thënë se më ka thënë gjyqtari S B-këtu i akuzuari se ti mundesh me i ndihmu M M i cili ishte i dyshuar për plaçkitje, mirëpo dëshmitari F Z nuk kishte pranuar, por se M i kishte treguar se ai ia ka dhënë 10000 €uro gjyqtarit-këtu të akuzuarit S Be, që ai d.m.th. M M të mbrohet në liri dhe të mbyllet kjo procedurë dhe se nuk e dinte me se çka ka ndodhë por M edhe sot ndodhet në liri.

3.2.17. Nga leximi i deklaratës së O B, e dhënë me datë 09.09.2020, pranë noterit Y M, sipas numrit rendor 6825/20, gjykata ka vërtetuar faktin se avokati O B, i cili ishte mbrojtës i të akuzuarit M Z- vëllait të dëshmitarit F Z, kishte dhënë deklaratë pranë noterit Y M në Pejë, në të cilën e kundërshtonte vërtetësinë e deklaratës së dëshmitarit F Z, e dhënë me datë 28.08.2019, në lidhje me pretendimet e tij se përmes avokatit O B, i akuzuari S B, kishte kërkuar që të takohet me dëshmitarin F Z, ne lidhje me çështjen e vëllait të tij për masën e dorëzarisë në shumë prej

3000€uro si dhe shpërblimin të cilin ai duhej ta jepte ne vlere prej 6000€uro për gjyqtarin – të akuzuarin S B dhe gjyqtarin S B.

3.2.18. Nga leximi i Shkresës së Sistemit të Menaxhimit të Kufirit, e datës 08.11.2022, për kalimin kufitar të personit Sami Berisha, për periudhën 01.01.2019 - 09.11.2022, ora 08:03 minuta, gjykata ka vërtetuar faktin se personi Sami Berisha- vëllai i të akuzuarit S B, sipas Sistemit për Menaxhimin e Kufirit –SMK, gjatë periudhës kohore të lartshënuar nuk kishte pasur asnjë Hyrje-Dalje në kalimet kufitare gjatë kësaj periudhe kohore prej me shumë se 3 vite.

3.2.19. Nga leximi i Raportit njoftues me numër te referencës 2019-KE-170, i datës 09.09.2019, i përpiluar nga rreshteri V Sh, gjykata ka vërtetuar faktin e veprimeve hetimore të cilat i kishte ndërmarrë hetuesi policor V Sh në lidhje me rastin konkret.

### 3.3. Mbrojtja e të akuzuarit

3.3.1 I akuzuari S B, në mbrojtjen e tij të dhënë në shqyrtimet gjyqësor të datave; 02.02.2023, 09.02.2023, 27.02.2023, 07.03.2023 dhe 21.03.2023, fillimisht ka deklaruar se ka lindur me datë .. në fshatin Baran, Komuna e Pejës. Shkollën fillore e ka kryer ne vendlindje, gjimnazin ne Pejë, ndërsa fakultetin Juridik në Universitetin e Prishtinës ne vitin 1981. I martuar, baba i 6 fëmijëve, ka 3 vëllezër dhe një motër, me te cilët formalisht janë bashkë, ngase pasurinë e trashëguar nga babai e kanë ende të pa ndarë, sepse njërin prind-nënë, e kanë gjallë, mirëpo faktikisht jetojnë të ndarë, ngase dy prej vëllezërve ka deklaruar se jetojnë jashtë, ndërsa njeri vëlla – S jeton në fshatin Baran, ndërsa i akuzuari jeton në Pejë. Tutje ka deklaruar se jeton në një banesë me qera, dhe nga pasuria e paluajtshme posedon shtëpinë dhe toke me sip. 4.5 ha, që është pasuri e përbashkët me vëllezërit e cila është e trashëguar nga babai, ndërsa si pasuri të luajtshme posedon 2 automjete, njeri i tipit Passat viti i prodhimit 1989, të cilën e kishte dhurate nga vëllezërit që nga viti 1999, ndërsa vetura tjetër e markës Mercedes e vitit 2005 që posedon dikund që 5 -6 vite e cila është ne emrin e te akuzuarit por e posedon dhe zakonisht e vozit djali i tij V, dhe pasuri tjetër nuk ka. Tutje ka shtuar së fëmijët e tij kanë mbaruar studimet që të gjithë në Kosovë dhe punojnë kryesisht neper biznese private. Puna e parë e tij pas studimeve ka qene si praktikant ne ish Sekretariatit Krahinor të Punëve te Brendshme, me pastaj ka vazhduar si Inspektor i Administratës, dhe nga viti 1988 ka kaluar ne Shërbimin e pasaportave si Udhëheqës i Punëve Kufitare - dokumenteve te udhëtimit dhe depërtimeve policore deri me 19.09.1990, kur edhe i ka përzënë Serbia me vendimet e tyre. Tutje ka shtuar se pas luftës është zgjedh .. për Kundërvajtje ne dhjetor te vitit 1999, në Gjykatën për Kundërvajtje në Peje, ku ka vazhduar me

punu deri ne reformën e vitit 2010, ku ka kaluar në Gjykatën e Qarkut në Peje, në çështje penale, dhe më pastaj në reformën e vitit 2013, ne Departamentin Krimeve te Renda ne Gjykatën Themelore në Peje, fillimisht në Departamentin e Përgjithshëm ka punuar 3 muaj, pastaj ka kaluar ne Departamentin për Krime te Renda dhe ka mbajtur këtë pozitë deri kur është suspenduar nga KGJK, dhe se kryesisht ka jetuar vetëm me të ardhurat që ka siguruar me rrogën e tij si ... I akuzuari S B tutje ka shtuar se bashkëshortja e tij Z Th, ka dy motra ku njëra jeton ne fshatin Baran, ndërsa motra tjetër T Th, jeton në Gjermani, me të cilën ka një lidhje më të ngushte, dhe se ka ndodhë që shpesh herë ti këtë lënë para dhe se po ashtu edhe paratë të cilat janë gjetur ne banesën e tij gjatë bastisjes pohon se kanë qenë të motrës së bashkëshortes së tij, d.m.th. të T Th, e cila i kishte lënë për shkak të disa renovimeve që ishin duke u bërë në shtëpinë e saj dhe që V- djali i të akuzuarit të paguante punëtorët për punën e kryer. Ndërsa sa i përket armës e cila është gjetur në banesën e të akuzuarit gjatë bastisjes, i njëjti ka deklaruar se arma është e vëllait të tij S, i cili pa dijeninë e tij ia kishte lënë bashkëshortes së të akuzuarit, dhe ka shtuar se asnjëherë pas luftës nuk kishte poseduar arme as nuk kishte marrë leje për armë ngase nuk e kishte ndier veten të rrezikuar, edhe pse si gjyqtarë ne çdo moment kishte mundur me legalizu arme pa problem, dhe se procesverbalin e bastisjes policia ia kishin dërguar në stacion policor për të nënshkruar, ku i njëjti ishte duke qëndruar ne ndalim. Tutje i akuzuari në mbrojtjen e tij ka deklaruar sa i përket punës së tij si gjyqtar, i cili në vitin 2013 kur ishte strukturuar gjykata, nga Gjykata e Qarkut (e cila ka qenë edhe si gjykatë e shkallës së dytë, ku i akuzuari në raste të caktuara ka deklaruar se ka qene edhe kryetar edhe anëtar i kolegjit) ne Gjykatën Themelore në Peje, ndarja e lëndëve kryesisht ishte bërë nga kryetari i gjykatës sipas radhës apo edhe sipas shortit, dhe se kishte pasur gjithsej 1000 lëndë, prej të cilave 400 lëndë i kishte trashëguar në DKR dhe 600 të tjera i kishin mbetur nga Departamenti i Përgjithshëm, e të cilat ia ka kryer dikund në vitin 2014. Ndërsa si gjyqtar i procedurës paraprake ka pasur radhën e kujdestarisë çdo 3 muaj, ngase kane qene 3 gjyqtar dhe secili ka mbajtur kujdestarin nga 1 muaj. I akuzuari ne mbrojtjen e tij ka deklaruar se për personin M Z, nuk ka pasur dijeni deri në ditën kur është ngritur aktakuza ndaj të akuzuarit S dhe se në kohën kur ai kishte një kërkesë për caktimin e paraburgimit nga prokurorja V D H, ndaj personit M Z, pas vlerësimit të të gjitha rrethanave, dhe po ashtu ishte edhe propozim i mbrojtjes, i ka caktuar masën e dorëzanisë dhe i kishte konfiskuar pasaportën, ngase kishte vlerësuar se masa e paraburgimit ishte masë më e rëndë, dhe kundër këtij vendimi të caktimit te dorëzanisë, prokuroria nuk kishte ushtruar ankesë. Ndërsa sa i përket seancës dëgjimore dhe pjesëmarrjes së dëshmitarit F Z, ne seancën e paraburgimit, i akuzuari ka deklaruar se nuk është e vërtet që i njëjti të ketë marrë pjesë në seancën e paraburgimit ngase ne seancën dëgjimore për caktimin e paraburgimit nuk lejohet publiku përveç palëve të domosdoshme ne seancë. Sa i përket deklarimit të dëshmitarit F Z, i cili

kishte deklaruar se në ditën kur është dërguar vëllai i tij në gjykatë, i akuzuari S B përmes mbrojtësit të M Z- avokatit O B, ka kërkuar që të takohet me dëshmitarin F Z, për çështjen e vëllait të tij, i akuzuari S në mbrojtjen e tij ka deklaruar se kjo gjë nuk është e vërtetë, ngase avokati O B ka qenë njeri parimor dhe të gjithë e kemi respektuar dhe nuk ka mundur të ndodhe një gjë e tillë, ku një deklaratë avokati e ka dhënë edhe para noterit në Pejë. Tuje ka shtuar se nuk ka kërkuar asnjëherë ryshfet nga F Z dhe nuk ishte ne dijeni për “marrëveshjen” që F Z dhe S B kishin pasur në lidhje me M Z, ku F Z, ne deklaratën e datës 09.09.2019, kishte deklaruar se S B i kishte kërkuar 3000 euro ti lë dorëzani për vëllain e tij(ku S Bishte anëtar i trupit gjykues sipas dëshmitarit F Z), ndërsa si shpërblim për te dhe gjyqtarin S B të lë shumën prej 6000 eurove, dhe se shumen prej 2000 eurove ia kishte lënë atij- gjyqtarit S B ne zyrën e tij dhe se i kishte mbetur borxh edhe 2000 mijë euro, i akuzuari S B ka deklaruar se kjo gjë është e pa vërtetë dhe është e pa kuptimtë dhe asnjëherë nuk është udhëzuar nga ana e tij për ndonjë gjë që ai ka deklaruar në deklaratat e tij, të cilat i ka mohuar në shqyrtimin gjyqësor. Ndërsa sa i përket çështjes se M Z, i cili ka qenë i akuzuari për veprën penale Kontrabandim me migrantë dhe i akuzuari S B, si kryetar i trupit gjykues, pasi që M Z, kishte pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohej, i kishte shqiptuar dënim me kusht me burg prej tre (3) vjet, me kusht për dy (2) vjet, i akuzuari ka deklaruar se nuk ka qene ne dijeni se ka qenë edhe gjyqtarë i procedurës paraprake në të njëjtën çështje, ngase lëndët e procedurës paraprake nuk i dorëzoheshin gjyqtarit bashkë me lenden me aktakuzë, dhe këtë e ka kuptuar vetëm ne momentin kur është ngritur aktakuza ndaj tij, dhe se dënime të tilla për vepra të tilla kanë shqiptuar edhe gjyqtar të tjerë. Ndërsa sa i përket takimit me dëshmitarin F Z, i akuzuari në mbrojtjen e tij ka deklaruar se ka pranuar që të takohet me të ngase dëshmitari F Z, i kishte shkruar mesazh që është një i afërm i mikut te tij pra vëllait të gruas dhe se ka një porosi prej tij prej jashtit, dhe pas disa insistimeve të tij kishte pranuar që të dali me të dhe ishin takuar në restorant “Toni” afër banesës së tij, i kishte thënë se ai e njihhte me herët të akuzuarin ku kishte punuar gjyqtar ne kundërvajtje, ndërsa i akuzuari ka deklaruar se nuk e ka njohur, e kishte fjalën për takimin e parë. Por edhe ne takimin i cili kishte ndodhur në ditën kritike me datën 19.09.2019, i akuzuari S B deklaroi se janë takuar në të njëjtin vend dhe se në takimin e dytë i cili kishte ndodhur afërsisht pas 1 jave ose 10 dite, F Z, përsëri kishte insistuar që të takohen me arsyetimin se dëshiron të i’a qes një dreke për shkak të respektit që ka për të dhe i kishte thënë që të thirr këndo që dëshiron ndonjë gjyqtar dhe te zgjedhin edhe vendin se ku dëshirojnë. I akuzuari S B, përsëri pas insistimeve të F Z, kishte pranuar që të dali më të, pasi që i njëjti e kishte thirr disa here që të pinin kafe edhe ne kohen e drekës, dhe meqë kishte insistuar përsëri F Z, kishin lënë takim në restorant “Toni” pas orës 16:00, pasi që të përfundonte punën i akuzuari S B. I akuzuari S B në mbrojtjen e tij ka deklaruar se në asnjë mënyrë nuk ka qenë ne dijeni e as lidhur me atë se çka po thotë për dajën dhe për



“marrëveshjen” që kishin pasur dhe se për shkak të mikrofonit që kishte dëshmitari Florim, i akuzuari shumicën e bisedës edhe nuk e kishte kuptuar dhe shumicën e kohës e pyeste se qysh çka, dhe ka shtuar se nuk e ka ditur që dëshmitari F Z kishte për ti dhënë ryshfet, sepse përndryshe nuk do të shkonte në takim. Në njërën nga pyetjet e mbrojtjes i cili e pyet se; vijim te bisedës dëgjohet F Z duke thënë ” *gjyqtar ato e lash ne kerr se s’ mrrita sot thash këtu ne restorant, thash ndac ti shti ne xhëp, ndac te qoj ne kerr, qoj dikah kështu, qysh dysh ti, ja qon dajës, që thotë daja se se len ai pa me thirr tani thotë jo pak jo diçka me kritikon. Me ka kritiku boll atë ditë në telefon*”, sipas fjalëve te F, ai po kërkon me ja qu dajës sipas “marrëveshjes” me dajën , a ka qene kështu a i ka thënë këto fjale F para teje”, i akuzuari S Bë shtë përgjigjur se “ *po shihet edhe prej videos se unë kam qenë i lodhur dhe i shpërqendruar prej punës dhe me te thane drejtën as se kam dëgjuar mire çka folke, por meqë janë ne transkript edhe incizim, ajo ishte mënyrë kamuflimit te tij që unë s’kam mujt as me kuptuar dhe ashtu janë fjalët e tij meqë janë ne video dhe transkript*”. I akuzuari S B gjatë mbrojtjes së tij ka deklaruar se nuk ka pas asnjëherë asnjë përmendje te parave, e as të ndihmës që i është bërë, as thirrje telefonike e as mesazhe, as ne takimin paraprak, edhe se nuk i kishte ndihmuar ndonjëherë dëshmitarit F Z, siç ai kishte deklaruar, kurrë ne asnjë mënyrë s’ka pasur dijeni se do të ketë zarfa e as se do të ketë diçka të ngjashme që ai ka ofruar, po ai kishte pranuar me dal në takim pas shume thirrjeve dhe insistimeve te tij dhe vetëm me qëllim sa me largu dhe mos me më thirr ma dhe se nuk kishte pasur asnjë qëllim te planifikuar për ndonjë përfitim, se po të kishte pas dikush qëllim për ndonjë përfitim nuk e kishte lënë me prit dikund 5-6 ore, pra kë shtuar se kurrë s’ka pasur as qëllim përfitimi, as premtimi dhe asnjë lloj ndikimi ne vendim, por ka shtuar se ka rene ne kurth te përgatitur nga një profesionist i cili me aftësitë e tij ishte ne gjendje te manipulojë pothuajse me çdo njeri. Tutje ka shtuar se nëse F Z, i ka dhanë një pjese te borxhit dikujt tjetër pse është deshtë kjo pjesa tjetër me iu dhanë të akuzuarit S pas 5 vite e gjysmë, dhe ka shtuar se kjo dëshmon mire se ishe një kurth shume mire i organizuar me një specialist te këtyre veprimeve i cili ka një përvojë shume te gjatë ne këtë lëmi për këto kurthe shume te sofistikuar dhe se i akuzuari kishte rënë në kurthin e tij. I akuzuari po ashtu ne pyetjen e mbrojtësit se :” *meqë dispozitivi i aktakuzës të ngarkon për vendim te favorshëm, ku si rezultat i këtij vendimi ju keni pranuar 2000 mije euro si ryshfet, e tepër për ta shkoqitur por a ka mundësi me na tregu se a ka pasur ndonjë veprim tendin çfarëdo cofte ai ne lidhje me lenden e M Z prej datës 22.08.2019 deri me datën 19.09.2019, kur ju jeni arrestuar, pra fryma e normës që unë e kuptoi e ju akuzoheni se e keni shkel i bie se pas marrjes se kësaj shume ju është dashur me krye një veprim ose mos me vepruar, meqenëse kane kaluar 5 vite prej datës së aktgjykimit, a ke pasur ndonjë kërkesë tjetër lidhur me këtë rast, cofte kërkesë për zbutje te jashtëzakonshme te dënimit apo çfarëdo mjete juridik që ju si gjyqtar i asaj çështje, i asaj kohe ishte dashur te vendosni dhe vendimmarrja ose veprimi është kushtëzuar me 2000*

*euro”, i akuzuari S B është përgjigjur se “ jo ne asnjë mënyrë ngase siç dihet lënda e përfunduar dorëzohet në administrate dhe gjyqtari nuk ka asnjë qasje ne lende, për me shume ai nuk ka as kompetencë mbi atë lende kur ajo përfundon dhe asnjë mundësi ligjore nuk ka pas me tutje për asnjë veprim, as për te ndryshuar dhe me këtë nuk kam pasur asnjë mundësi as me detyru as me kushtezu as me frikesu apo ndonjë mënyrë tjetër e presionit te cilin atë e kishte detyruar për ndonjë përfitim dhe teoria për mi besua se kinse një obligimi moral të një mashtruesi është e pa kuptim dhe absurde kur behet fjale për 5 vite e gjysmë”. I akuzuari S B, pas deklarimit në pyetjet e mbrojtësit të tij, dhe pas konsultimit me mbrojtësin e tij, ka zgjedhur që të mbrohet në heshtje.*

#### 4. Gjetjet e gjykatës në raport me aktgjykimin

Gjykata në raport me këtë çështje penale dhe aktin akuzues të parashtruar në këtë çështje penale, së pari do ta shtjelloj: vërtetimin e gjendjeve faktike në këtë çështje penale e për të cilat i akuzuari është shpallur fajtor; cilësimin juridik të veprave penale në raport me gjetjet të cilat kanë rezultuar me administrimin e provave në këtë çështje penale; provat dhe faktet të cilat kanë sjellë deri tek gjetja fajtor e të akuzuarit; pretendimet e mbrojtjes për çështjet e caktuara të parashtruara në fjalë përfundimtare; çështjen e konfiskimit-kthimit, dënimit, dënimit plotësues dhe të shpenzimeve procedurale.

#### 5. Gjendja faktike dhe cilësimi juridik në raport me gjendjen faktike për pikën I të dispozitivit të aktgjykimit

Gjykata, në këtë çështje penale ka vetëtuuar gjendjen faktike sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Në një përshkrim të shkurtër, ka vërtetuar se i akuzuari me datën 19 shtator 2019 në Pejë, si person zyrtar, gjyqtar i Republikës së Kosovës në Gjykatën Themelore në Pejë – Departamenti për Krime të Rënda, në mënyrë të drejtpërdrejtë ka pranuar dhuratën për vete dhe për personin tjetër të ashtuquajtur “daja”, në atë mënyrë që ditën kritike i akuzuari kishte lënë takim me dëshmitarin F Z dhe pas përfundimit të orarit të punës me të njëjtin janë takuar për drekë në restorant “Toni” në Pejë, për shkak se dëshmitari ia kishte sjellë të akuzuarit si dhuratë paratë në vlerë prej dymijë (2000) Euro, për të cilën shumë ishin dekoduar me dëshmitarin me herët (në kohën e procedimit të çështjes) që pas përfundimit të rastit ku si i akuzuar ishte vëllai i

dëshmitarit F Z, ndërsa si kryetar i trupit gjykues ishte i akuzuari S B, ashtu që i njëjti të veprojë në pajtim me detyrën e tij zyrtare (ta marr një vendim më të favorshëm për vëllain e dëshmitarit), me ç'rast edhe e kishte marrë Aktgjykim me numër PRKP.nr.46/15, të datës 05.01.2016, për dy veprat penale të kontrabandimit me migrantë nga neni 138 të KPRK-së për të cilat akuzohej, i kishte shqiptuar dënim të kushtëzuar me burg prej tre (3) viteve, i cili dënim nuk do të ekzekutohej në afat prej dy (2) viteve, ashtu që i akuzuari ditën kritike pas përfundimit të drekës së bashku me dëshmitarin F, dalin nga restoranti "Toni" dhe të njëjtit kanë shkuar tek vetura e dëshmitarit ashtu siç ishin darkorduar gjatë drekës dhe pasi që kanë hyrë brenda, i akuzuari ka pranuar nga dëshmitari shumën e parave në vlerë prej dymijë (2000) Euro dhe pasi del nga vetura e dëshmitarit duke shkuar në veturën e tij arrestohet nga Policia të cilët që nga fillimi i takimit të akuzuarin e kishin nën vëzhgim të masave të fshehta.

PSRK, me rastin e ngritjes së aktit akuzues ka akuzuar të akuzuarin S B, në pikën I të aktakuzës për veprën penale marrje e ryshfetit nga neni 421 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Në këtë drejtim fillimisht gjykata konstaton se PSRK, në aktin akuzues në pikën I, në kualifikimin juridik gabimisht kishte lidhur paragrafët e veprës penale nga neni 421 i KPRK-së, pra paragrafin 2 lidhur me paragrafin 1 të këtij neni, pra kjo lidhje e paragrafëve nuk mund të bëhet, për shkak se këto paragrafë elemente kanë dallues të kësaj vepre penale, pra paragrafi 1 si element ka që: "personi zyrtar të veprojë ose të mos veprojë në pajtim me detyrën e tij zyrtare, ndërsa paragrafi 2 si element ka që: "personi zyrtar të veprojë ose të mos veprojë në kundërshtim me detyrën e tij zyrtare". Po ashtu kanë dënime të ndryshme, andaj gjykata ka ardhur në përfundim se Kodi Penal i Republikës së Kosovës, në nenet tjera kur mund të bëhet lidhja e paragrafëve njeri me tjetrin ka përdorur shprehjen: "nëse vepra penale nga paragrafi 1<sup>5</sup>", që në rastin konkret tek vepra penale nga neni 421 të KPRK-së ligjvënësi nuk e ka përdorur këtë shprehje siç është cituar më lartë.

Gjendja e lartë-theksuar faktike, është gjendje të cilën e ka vërtetuar gjykata me rastin e procedimit të kësaj çështjeje penale dhe provave të saj. Bazuar në këtë gjendje faktike, gjykata ka bërë ri-cilësimin juridik të veprës penale, nga ai ri-cilësim i veprës për të cilin është parashtruar akti akuzues.

---

<sup>5</sup> Shiqo: Kodi Penal i Republikës së Kosovës, nr.06/L-074, tek kapitulli XXXIII, Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare, neni 415 të KPRK-së.

Gjykata, konsideron se gjetjet gjatë shqyrtimit gjyqësorë nuk e kanë vërtetuar veprën penale marrje e ryshfetit nga neni 421 par.2 të KPRK-së, mirëpo ka vërtetuar se në rastin konkret i akuzuari ka kryer veprën penale marrje e ryshfetit nga neni 421 par.1 të KPRK-së.

Gjykata, sa i përket ri-cilësimit të veprës penale për shkak të mos gjetjes së veprës penale nga par.2 i nenit 421 të KRRK-së, do ta bëjë elaborimin më poshtë:

Vepra penale marrje e ryshfetit nga neni 421 par.2 të KPRK-së, ka përcaktuar se: *“Personi zyrtar i cili në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, kërkon ose pranon ndonjë dhuratë apo përfitim tjetër për vete apo personin tjetër, ose që pranon ofertën apo premtimin për dhuratë apo përfitim të tillë, në mënyrë që personi zyrtar të veprojë ose të mos veprojë në kundërshtim me detyrën e tij zyrtare, dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre (3) vite deri në dymbëdhjetë (12) vjet”* që rrjedhe se elementet e kësaj vepre penale janë: Kërkesa apo pranimi i dhuratës, ofertës apo premtimit, për vete apo për tjetrin, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejt apo të tërthortë, në mënyrë që personi zyrtar të veproj apo mos veproj në kundërshtim me detyrën e tij zyrtare.” Nga këto elemente rezulton se veprimi i personit zyrtar duhet të jetë fillimisht brenda kompetencave të tij dhe se ai veprim si kompetencë e tij duhet të jetë në kundërshtim me detyrën (që do të thotë se veprimin e tij zyrtari duhej të mos e kryente).

Në Rastin konkret për gjykatën fare nuk ka qenë kontestuese fakti se të akuzuari S B, i takon cilësia e personit zyrtar që është përcaktuar me nenin 120 par.1 dhe par.2 nënpar.2.1 të KPRK-së, për shkak se në kohën kur janë nxjerrë vendimin si në dispozitiv, i akuzuari S B ishte gjyqtar i Republikës së Kosovës, pranë Gjykatën Themelore në Pejë – Departamenti për Krime të Rënda, dhe kishte kompetencë të shqyrtonte rastet pranë këtij departamenti me të cilat ngarkohej, .

Po ashtu, nuk ka qenë kontestues fakti se në rastin penal që ishte zhvilluar pranë Gjykatës Themelore në Pejë, me shenjen PRKP.nr.46/15 ku ishte si i akuzuar M Z, vëllai i këtu dëshmitarit F Z, i akuzuari S B në këtë rast kishte vepruar si gjyqtar i procedurës paraprake përkatësisht kishte marr aktvendimin me shenjen DKR.PP.nr.172/14, i datës 27.06.2014, ashtu që ndaj të pandehurit M Z, i dyshuar për kryerjen e dy veprave penale Kontrabandimi me migrantë nga neni 138 par.1 të KPRK-së, kishte refuzuar kërkesën e prokurorisë për caktimin e Paraburgimit ndaj M Zt, dhe ndaj të njëjtit kishte caktuar Masën e Dorëzanisë në lartësi prej 3000(tremije) Euro.

Gjithashtu, për të njëjtin rast kishte vepruar edhe si gjyqtar përkatësisht në shqyrtimin gjyqësor si kryetar i trupit gjykues, me ç'rast kishte marr aktgjykimin PRK.P.nr. 46/15 i datës 05.01.2016, me të cilin kishte vendosur që të akuzuarin M Z – vëllait të dëshmitarit F Z, i akuzuar sipas Aktakuzës me nr. PP.nr.100/2009 të dt. 04.03.2015, për dy vepra penale Kontrabandim me migrantë nga neni 138 par. 1 të KPRK-së, të njëjtin e kishte shpallur fajtor për veprat penale për të cilat akuzohej dhe ishte dënuar me dënim me kusht në kohëzgjatje prej 3 (tre) vitesh me kusht në periudhën kohore për dy vite, dhe me gjobë prej 1000 (njëmijë) Euro.

Pra, si me rastin kur kishte refuzuar kërkesën e prokurorisë për caktimin e Paraburgimit ndaj M Z, dhe ndaj të njëjtit kishte caktuar Masën e Dorëzanisë, si dhe një marrjen e aktgjykimit PRK.P.nr. 46/15 i datës 05.01.2016, i njëjti kishte marr veprime në kudër të autorizimeve të tij zyrtare, pra si gjyqtar pranë Departamentit për Krime të Rënda, të Gjykatës Themelore në Pejë, pra ishte veprim i tij zyrtar ishte se duhej ta kryente.

Prandaj, pretendimi e PSRK-së se i akuzuari S B si person zyrtar – gjyqtar, kishte vepruar në kundërshtim me detyrën e tij zyrtare, në çështjen penale ndaj M Z - vëllai i këtu dëshmitarit F Z, kur kishte qenë në të njëjtin rast si gjyqtar i procedurës parapake dhe pastaj e kishte gjykuar si kryetar i trupit gjykues, për shkak se kjo ishte kundërshtim me dispozitat e KPP-së, të cilat përcaktonin si bazë për përjashtimin e gjyqtarëve në qoftë se njëjti gjyqtar ka marr pjesë në procedurën e mëhershme në të njëjtin rast, ky pretendim sipas vlerësimit të gjykatës është i pa bazuar për shkak të arsyeve si në vijim:

Fillimisht i pakontestueshëm për gjykatën ka qenë fakti se pas marrjes së aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë – Departamenti për Krime të Rënda me shenjen PRK.P.nr.46/15 i datës 05.01.2016, ndaj të njëjtit nuk ishte parashtruar ankesë nga ana e Prokurorisë Themelore në Pejë, apo palëve tjera në procedurë, ashtu që aktgjykimi ishte bërë i plotfuqishëm me datë 15.02.2016.

Fakt i pakontestueshëm tjetër ishte se kur i akuzuari S B, kishte vendosura në rastin lartpërmendur kishte vepruar si gjyqtar i procedurës parapake dhe pastaj e kishte gjykuar si kryetar i trupit gjykues, kjo ishte në kundërshtim me dispozitat e KPP-së, për shkak edhe sipas nenit 23 par.2 të KPP-së është përcaktuar se: *“Gjyqtari i procedurës parapake mbikëqyrë procedurën penale gjatë fazës së hetimit. Me paraqitjen e aktakuzës, gjyqtari i procedurës parapake nuk ka më kompetencë mbi të pandehurit e përmendur në aktakuzë”*. Gjithashtu edhe në nenin 49 të KPRK-së, ku janë përcaktuar edhe kushtet për shqiptimit e dënimit me kusht paragrafi 3 i këtij neni, ka pacaktuar se: *“ Dënimi me kusht mund t'i shqiptohet kryesisht sipas*

*paragrafit 1. dhe 2. të këtij neni nëse gjykata shqipton dënimin me gjobë ose me burgim deri në dy (2) vjet, qoftë për një veprë penale ose për disa vepra në bashkim”, pra në rastin konkret është kushtëzuar dënimi me burgim prej tre (3) vite, për çka ka mundur të vlerësohet se aktgjykimi ishte në kundërshtim edhe me këtë dispozitë.*

Mirëpo gjykata ka ardhur në përfundim se pretendimi i prokurorisë se i akuzuari kishte vepruar në kundërshtim me detyrën e tij zyrtare është pabazuar, për shkak se tani aktgjykimi është i formës se prerë, kjo gjykatë nuk mund vlerësoj aktgjykimin e plotfuqishëm të Gjykatës Themelore në Pejë – Departamenti për Krime të Rënda PRK.P.nr.46/15 i datës 05.01.2016, se a ishte përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale apo në shkelje të ligjit penal apo shkelje të tjera, apo edhe shkelje disiplinore për shkak se këto rrethana i kanë takuar asaj procedure dhe kanë mund të shqyrtohet dhe konstatohet vetëm nga gjykatat më të larta, çoftë nga Gjykata Apelit apo Supreme e Kosovë, nëse do të ishin parashtruar mjetet juridike - të rregullta apo të jashtëzakonshme, pra tani më kemi një aktgjykim të plotfuqishëm, dhe se klauzola e plotfuqishmërisë së aktgjykimit mund të anulohet vetëm sipas mjeteve të jashtëzakonshme juridike.

Gjykata ka ardhur në përfundim se i akuzuari nuk kishte vepruar në kundërshtim me detyrën e tij zyrtare, por kishte vepruar në pajtim me detyrën e tij zyrtare kur kishte nxjerr aktgjykimin me shkeljet siç pretendon PSRK, sepse nxjerra e aktgjykimeve ka qenë në pajtim me detyrën e tij zyrtare si gjyqtar (kryetar i trupit gjykues), pra siç kishte nxjerrur aktgjykimin e lartpërmendur dhe aktgjykime tjera pas përfundimit të procedurës penale edhe për raste tjera, pra ka qenë gjyqtar në kuadër të Departamentit për Krime të Rënda të Gjykatës Themelore në Pejë, ashtu që gjyqtari e ushtron funksionin e tij në mënyrë të pavarur, bazuar në Kushtetute, Ligj dhe vlerësimin individual të fakteve, pa ndonjë kufizim, ndikime të padrejta, nxitje, presione, kërcënime ose ndërhyrje, direkt ose indirekt, nga çdokush e për çfarëdo arsye, duke ruajtur dhe promovuar pavarësinë në aspektin individual dhe institucional, pra nxjerrja e aktgjykimit ishte në kudër të autorizimeve të tij zyrtare si veprim i tij zyrtar që duhej ta kryente, ashtu që vepra penale marrja e ryshfetit nga par.1 i nenit 421 të KPRK-së, si veprim të kryerjes si elemente ka kur kërkohet apo pranohet dhurata apo çfarëdo përfitimi tjetër apo premtimit për të, kjo dispozitë nuk ka përcaktuar që është e domosdoshme që të jetë ndërmarr një veprim i paligjshëm, për të cilin është pranuar dhurata apo çfarëdo përfitimi tjetër, prandaj vet fakti se i akuzuari për rastin konkret kishte pranuar si dhuratë për vete dhe për personin tjetër të ashtuquajtur “daja” shumën prej 2000 Euro, këtë e bën si veprim të paligjshëm të tij dhe konsumohen elementet e veprës penale, prandaj gjykata pas administrimit të provave ka ri-cilësuar veprën penale për shkak se

nuk është vërtetuar se i akuzuari S B ka kryer veprën penale marrje e ryshfetit nga par.2 i nenit 421 të KPRK-së, mirëpo ka vërtetuar se në rastin konkret i akuzuari ka kryer veprën penale marrje e ryshfetit nga neni 421 par.1 të KPRK-së.

6. Gjetjet e gjykatës (Fajësia e të akuzuarit në raport me gjendjen faktike për pikën I të dispozitivit të aktgjyimit)

Gjykata, nga të lartpërmendurat, meqenëse nuk ka gjetur se ekziston se i akuzuari kishte vepruar në kundërshtim me detyrën e tij, ka ri-cilësuar veprën penale në nenin 421 par.1 të KPRK-së me të cilën përcaktohet se: *“Personi zyrtar i cili në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, kërkon ose pranon ndonjë dhuratë apo përfitim tjetër për vete apo personin tjetër, ose që pranon ofertën apo premtimin për dhuratë apo përfitim të tillë, në mënyrë që personi zyrtar të veprojë ose të mos veprojë në pajtim me detyrën e tij zyrtare, dënohet me gjobë dhe me burgim prej një (një) vit deri në tetë (8) vjet”*. Pra si veprime inkriminuese e kësaj vepre penale konstatohet është sanksionimi i veprimeve të personave zyrtar, të cilët në kuadër të detyrës së tyre zyrtare që e ushtrojnë, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, kërkojnë ose pranojnë ndonjë dhuratë apo përfitim tjetër për vete apo personin tjetër, ose që pranojnë ofertën apo premtimin për dhuratë apo përfitim të tillë veprojnë ose të mos veprojnë në pajtim me detyrën e tij zyrtare.

Fakt i pakontestueshëm ishte se i akuzuari S B, me datën 19.09.2020, pas përfundimit të orarit të punës ku punonte si gjyqtar panë Gjykatës Themelore në Pejë, kishte lënë takim dhe ishte takuar me dëshmitarin F Z, për drekë në restorant “Toni” në Pejë, pasi që këtë fakt nuk e mohon edhe vet i akuzuari.

Faktin se takimi ne mes tyre ishte për shkak se dëshmitari F Z, ia kishte sjellë të akuzuarit si dhuratë paratë në vlerë prej dymijë (2000) Euro, për të dhe për pësonin daja, ky fakt vërtetohet nga videoincizimi DVD 1, përkatësisht nga biseda e zhvilluar ndërmjet tyre, ku dëshmitari F Zi drejtohet të akuzuarit S B me fjalët si në vijim: F Z: *“unë ka ni dhuratë jau kom ba, e ta jepi ty e ndaq ja qon qysh jom marr vesh me dajën ja jep ti atina, jo e keni meritu se une jom marr vesh me të qashtu po unë i kom vonu për s’tepri po ishalla hajr. I akuzuari S B: (heshtje)<sup>6</sup>.*

Biseda në mes tyre vazhdon duke i thënë dëshmitari F Z, të akuzuarit S Bse; *“F: gjyqtar, ato e lash në kerr se s’muja se thash ktu o restorant e thash i shti ne xhep, t’hypi në kerr, t’qoj dikah*

<sup>6</sup> Shiqo DVD-Videoingjizimin 1, në nga minuta 4:31 sekonda.

*kshtu, qysh dush ti, ja qon dajës, që thot daja, se ai, se len pa m' thirrë, no pak no diqka m'kritikon, m'ka kritiku boll at ditë n' telefon, S B: po a? F: po, m' tha je hup krej m' tha ti veq sikur ata magjupt tha kceva ujt t' dh.. go, i thash o vallai thash Dajë, n' spital kesh atëherë kur ke a din, atëher i thash edhe unë mas do punve mas do, po ngarkohet njeri po për ata mirë e ka se edhe nime u shku përime kohë e gatë u shku tepër, u kryn tana kshtu senet hehe<sup>7</sup>”*

Po ashtu biseda në mes tyre vazhdon duke i thënë dëshmitari F Z, të akuzuarit S B se; F Z: *“atij i bën të fala, i thu që i doken apat pak a diqka thuj le t' më thurret, e lajmë apat naj takim”, S B mohon me kokë pas këtyre fjalëve të dëshmitarit. F Z: “po m'ka thanë qikaq a pe din, e, e kom pak mangu e kom lan apat, ka njëmijë jau kom pru, ty nja, atij nja, ai m'ka thanë tri, ka nja e gjys e, qato që jon kon a din, qysh po i thojnë se po harroj a din për mos me ikë, depozit, S B: po<sup>8</sup>;*

Pra, nga bisedat e lartpërmendura në tërësi vërtetohet fakti se, takimi ishte për pranimin e dhuratës që i'a kishte sjellë dëshmitari F Z të akuzuarit S B, dhe personit të ashtuquajtur “Daja”.

Në këtë drejtim pretendimi i mbrojtjes se gjatë qëndrimit në restorantin “Toni” nuk është folur kurrë për ndonjë ryshfet sepse dëshmitari F Z në nxitjen e policisë dhe me qëllim të realizmit të interesit të tij dhe për të i'u shmangur burgut nuk ka guxuar që të përmend para dhe gjatë drekës me frikën se S B do të ngrihet nga tavolina, ky pretendim është i pa bazuar dhe nuk qëndron për shkak se nga bisedat e lartshënuara shihet shumë qartë se dëshmitari i drejtohet të akuzuarit me fjalët se *“iu kam bërë nga një dhuratë, ty dhe dajës”* dhe po ashtu i njëjti ia përmend edhe shumë e parave që ia kishte sjellë si dhuratë *“një mijë për ty dhe një mijë atij”, “të hypi në kerr të qoj dikah kshtu, qysh don ti”, dhe pastaj ia qon edhe dajës se ai nuk e lenë pa më thirrë dhe më kritikon.* Po ashtu, në këtë drejtim përveç bisedave të lartpërmendura dëshmitari F Zi drejtohet të akuzuarit me fjalët se: *“s'pat as ven as për parking qaty keq e lash, i kom shti në zarf, në zarf i kom shti edhe i lash qaty mi dokumenta se, ktu thojsha mos po, spo shoh diqka po, a ki pa që thojnë i fryn kungullit tani, nifar fjale, ti mi ki msu hahah, pasha fmin kjo meritë e jotja osht meritë e jotja haha”, S B i përgjigjet këtyre fjalëve duke pohuar herë pas here “po po<sup>9</sup>”.* Pra nga të gjitha këto biseda të lartpërmendurat gjykata ka ardhur në përfundim se në rastin konkret nuk qëndron pretendimi i mbrojtjes se dëshmitari nuk kishte guxuar të përmend para dhe gjatë drekës ryshfetin me frikën se i akuzuari S B do të qohej nga tavolina, ngase se përkundër faktit se në

<sup>7</sup> Shiqo DVD-Videoingjizimin 1, në nga minuta 5:55 sekonda.

<sup>8</sup> Shiqo DVD-Videoingjizimin 2, në nga minuta 6:20 sekonda.

<sup>9</sup> Shiqo DVD-Videoingjizimin 1, në nga minuta 14:05 sekonda.



video incizim shihet dhe shumë qartë dëgjohet biseda ku dëshmitari Florim kishte përmendur dhuratën, që i'a kishte sjellë atij dhe për personit të ashtuquajtur "Daja", po ashtu i njëjti e përmend edhe shumë nga një mije, gjithashtu i kishte treguar të akuzuarit se nuk i kishte sjellë në restorant nga frika se mos po shihej nga ndokush dhe se këto do të i'a jepte në veturë ku i tregon edhe për vendin ku i kishte vendosur përkatësisht tek pjesa dokumenteve, dhe po ashtu kishte përmend edhe fjalën popullore „ *a ki pa që thojnë i fryn kungullit tani* „, dhe nga gjithë këto biseda në asnjë moment përkundër i akuzuari nuk kishte lëvizur qofte nga tavolina dhe po ashtu nuk mund të konkludohet se i akuzuari nuk ishte në dijeni për bisedën që po zhvillohej ngase i njëjti po të mos kishte dijeni për bisedën që po zhvillohej asnjëherë për më shumë se një orë gjate takimit që kishin bërë së bashku nuk e kishte pyetur dëshmitarin se për çka po fliste, pra nga kjo rrjedh se i akuzuari ishte në dijeni se dëshmitari ia kishte sjellë dhuratën që më pas në video incizimin në veturë shihet qartë se i akuzuari së bashku me dëshmitari shkojnë tek vetura e tij dhe i pranon në mënyrë të drejtpërdrejt nga dëshmitari F Z, dhuratën në vlerë prej 2000 mijë euro në dy (2) zarfa, ashtu siç ia kishin biseduar së bashku në restorantin "Toni" që do të elaborohet në vijim.

Nga video incizimin në veturë shihet qartë se dëshmitari F Z, hyn në veturë dhe ulet në ulësen e vozitësit, ndërsa menjëherë pas tij hyn edhe i akuzuari S B, i cili ulet në karriken e pasagjerit dhe po ashtu dëgjohet biseda në mes tyre duke i thënë dëshmitari F Z të akuzuarit S B se: "*që qeto i ki, në zarfë janë, njani zarf është për ty, njani për dajën, qe njajtë i ki krejt, s'kum shkru as emra as kurgjë kshtu se, a din, njani për ty njani për dajën, dajës i thu n'qoftse s'është i knaqun dalim edhe i her se edhe për një mjishe mka thanë, a di po folim reale, m'ka thanë qato tremij i thash s'ka problem, e veq dy mijë janë, a din po t'kallxoj kshtu, hajd pra me t'mira*" S B: "*ani tu rrit nera*". F: "*edhe ty nera, zoti të dhashtë bereqet*", S B: "*e gzofsh kerrin se e paske bet*", F Z: "*bashke ishalla*". Pra nga video incizimi dhe bisedat që dëgjohen në video incizim, vërtetohet se i akuzuari në mënyrë të drejtpërdrejt kishte pranuar shumë prej dymijë (2000) Euro si dhuratë për vete dhe për personin e ashtuquajtur "daja", pra njëmijë (1000) për vetë, njëmijë (1000) për dajën, prandaj pretendimi i mbrojtjes se i akuzuari nuk kishte dijeni për dhuratën, ky incizim dhe kjo bisedë e bën dhe më të paqëndrueshëm për shkak se përveç që i akuzuari e pranon dhuratën, përkatësisht shumë prej (2000) Euro, i njëjti e falënderon duke i thënë: "*ani, tu rrit nera*", pra kjo vërteton faktin se i njëjti e pohon duke thënë: "*ani*" pastaj e falënderon me fjalët "*tu rrit nera*", pra kjo vërteton faktin se qysh nga fillimi i akuzuari kishte dalë për ta pranuar dhuratën nga dëshmitari F Z.

Pretendimi i mbrojtjes se dëshmitari F Z, kishte trilluar dhe kamufluar faktet dhe rrethanat gjatë bisedës se përgjuar në mënyrë që i akuzuari S B vërtetë të kujtojë se dëshmitari kishte folur me “dajën”- gjyqtarin S B dhe se bëhej fjalë për dhuratë pa ndonjë qëllim të përcaktuar, ky pretendim i mbrojtës është i pa bazuar dhe nuk qëndron për shkak se duke marrë për bazë rrjedhën e gjithë bisedës, përkatësisht qysh në fillim të kësaj bisede shihet qartë se edhe i akuzuari kishte një komunikim paraprak me “dajën” dhe kjo vërtetohet nga biseda në mes të dëshmitarit dhe të akuzuarit S Be cila zhvillohet në këtë mënyrë: “F Z: *Daja hala pa qef a? S B: nuk o qaq po, ai qashtu mu arsyetu po, menimi jem osht se pej tute ma tepër, (ku dëgjohet edhe duke qeshur i akuzuari)*”, F Z: “*edhe mu me tha se si ligshavt diqysh jam, edhe i thash s’ka lidhje kur dush, S B: Edhe me neve po priton me dal<sup>10</sup>*”. Pra nga kjo bisede vërtetohet se i akuzuari S B vetëm kishte dalur në takim që ta pranojë dhuratën nga dëshmitari F Z, dhe se pretendimi i mbrojtjes se biseda ishte një trillim dhe kamuflim nuk qëndron duke marrë për bazë faktin se pothuaj gjatë gjithë bisedës dëshmitari e përmend dhuratën, dhe duke marrë për bazë personalitetin e të akuzuarit, përkatësisht nivelin e tij si .. në Departamentin e Krimeve të Rënda në Gjykatën Themelore në Pejë, nuk mund të konkludohet se i akuzuari nuk e kishte kuptuar të gjithë esencën e bisedës që po zhvillohej në mes tyre dhe nuk mund të konkludohet se nuk kishte biseduar edhe vet i akuzuari para daljes me të ashtuquajturin “daja,, gjyqtarin-S B, ngase vet në bisedë dëgjohet duke i thënë dëshmitarit kur e pyet dëshmitari F Z se *Daja hala pa qef a?*, i akuzuari përgjigjet se “*nuk o qaq po, ai qashtu mu arsyetu po, menimi jem osht se pej tute ma tepër*” pra vet e pranon se për mos daljen e tij ju kishte arsyetuar se ishte i sëmur por i akuzuari e kishte vlerësuar se më shumë prej tute.

Faktin se i akuzuari i kishte pranuar parat si dhuratë, për rastin ku si i akuzuar ishte vëllai i dëshmitarit F Z, ndërsa i akuzuari S B si kryetar i trupit gjykues ishte, në mënyrë që i njëjti të veprojë në pajtim me detyrën e tij zyrtare (ta marr një vendim më të favorshëm për vëllain e dëshmitarit), gjykata këtë fakt po ashtu e ka vërtetuar nga video-incizimi përkatësisht nga biseda që zhvillohet në mes dëshmitarit dhe të akuzuarit ku dëshmitari F Z i drejtohet me fjalët të akuzuarit se: “*Që shkum, me pranim të fajësise, se ky e ka pranu fajësinë, u pendu, veq u tutke fort, u pat tut ai vellau*”. Pra gjatë kësaj bisede dëgjohet duke fol dëshmitari me të akuzuarin për frikën e vllait të tij, e po ashtu gjatë rrjedhës së kësaj bisede i njëjti bisedon edhe për pjesëmarrësit në seancë, pjesëmarrjen e prokurorit të çështjet dhe për sjelljet e tyre gjatë seancës. Po ashtu edhe vet dëshmitari F Z, gjatë dëshmisë të tij në shqyrtimin gjyqësorë edhe pse kishe mohuar shumicën e fakteve që ishin përmendur dhe dëgjohen gjatë bisedës së tij në videoincizim me të

<sup>10</sup> Shiqo DVD-Videoincizimin 1, në nga minuta 03:42 sekonda.

akuzuarin S B, kur është ballafaqur me videoincizimin nga ana e Ktgj-së, rreth bisedës së tij “Kur i ishte drejtuar me fjalët të akuzuarit S, se nuk është obligim larg qoftë, se ju i keni kry ato punë”, pra i pyetur nga KTGJ se cilave punë po i referohesh këtu, çfarë punë kanë kry ata? Dëshmitari F Z është përgjigjur se: “për punën e vllaut që e ka kry që me mbyll çështjen, se unë nuk e ndi vetën si obligim por prap jam ardhur në mënyrë njëzore me tu falenderu”.

Në këtë drejtim dëshmitari F Z, në shqyrtim gjyqësor ka mohuar faktet që kishte përmendur në dy deklaratat të cilat i kishte dhënë në fazat fillestare hetimore në polici përkatësisht atë të datës 09.09.2019 dhe të datës 23.09.2023, pra i njëjti kishte mohuar faktet që i kishte përmendur në këto dy deklarata dhe faktet të cilat dëgjohen në bisedën në video-incizim dhe atë me pretendimin se këto deklarime i kishte bërë për të bashkëpunuar me policinë e prokurorin e çështjes për të arrestuar të akuzuarin S B dhe se nga e atyre atij i ishte premtuar se do ti ndihmonin që të lirohej nga dënimi për veprat penale për cilat ishte dënuar më parë dëshmitari dhe tani ishte çështja ishte në ekzekutim të dënimit. Gjykata për ta vërtetuar këtë fakt, ka dëgjuar në cilësi të dëshmitarit policin hetues të rastit V Sh.

Dëshmitari V Sh, gjatë dëshmisë së tij në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se: “asnjëherë nuk i ka premtuar F Z që do ti ndihmonte në çështjen që ai kishte pasur me ligjin dhe asnjëherë nuk i ka ndihmuar që ai të lirohej nga arrestimi dhe këtë ka theksuar se e deklaroj me përgjegjësi penale dhe morale”. Ai ka sqaruar se gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarit F Z nga deklaratat e tij shihet se i janë lexuar të drejtat dëshmitarit apo ankuesit i cili ka raportuar rastin në polici, pastaj është zhvilluar intervista dhe në fund i është dhënë deklarata që ta lexojë dhe i njëjti është pajtuar me atë që ka thënë dhe të njëjtën e ka nënshkruar me vullnetin e tij të lire. Tutje ky dëshmitar ka deklaruar se para këtij rasti nuk e ka njohur me parë as ankuesin F Z e as të akuzuarin S B dhe se fillimisht hetimi ka filluar pasi ankuesi F Z, kishte ardhur që të raportojë një lëndë ndaj një gjyqtari të Apelit, ku emri nuk i kujtohej, ku sipas tij kanë kërkuar rreth 200 mijë euro me qëllim që të ja zbresin apo të ja heqin vuajtjen e dënimit që ka pasur për një rast ankuesi F Z, dhe të ia kthejnë në pikën zero hetimin, dhe gjatë vazhdës se hetimeve ndër tjera e ka potencuar edhe lëndën ndaj S Bs, si dhe ndaj një gjyqtari tjetër të Pejës që emri nuk i kujtohej, ku ka deklaruar se këta dy persona i kanë kërkuar para me qëllim që ti ndihmojnë në procedurën gjyqësore vëllait të F Z, ju kishte dhënë një shumë rreth 4000 euro me qëllim që ti ndihmojnë në procedurën gjyqësore ndaj vëllait të tij për veprën penale Kontrabandim me migrantë, dhe se sipas tij ka pasur me i dhënë edhe 2000 euro si rezultat i kësaj marrëveshje. Dhe në kohën kur ka dhënë deklaratën dëshmitari F Z, ka thënë se ata janë të gatshëm që ti marrin këto para pasi që ai ka komunikim me ata...”. Pra nëse analizohet deklarata e dëshmitarit V Sh, në asnjë rrethana

nuk mund të konkludohet se i njëjti i kishe premtuar dhe kërkuar bashkëpunim dëshmitarit F Z me policinë në fazën e procedurës paprakrake, me qëllim për të arrestuar të akuzuarin S B ku pastaj do ta ndihmonin të njëjtit që të lirohej nga dënimi për veprat penale për cilat ishte dënuar më parë dëshmitari të cilat i kishte në ekzekutim të dënimit. Dëshmitari V Sh ka sqaruar se: *“deklarata e deponuar në polici e datës 09.09.2019, së bashku me një shënim zyrtarë është dërguar në Prokurori Speciale tek prokurori i lëndës B I, pastaj me rekomandimet e tij fillimisht është ngritur kallëzim penal për dy gjyqtarët në fjalë dhe është bërë kërkesë nga ana e tyre për masë të fshehtë të simulimit për të cilat edhe është lëshuar urdhëresë nga ana e gjykatës dhe ka filluar implementimi i kësaj urdhërese, ku kjo procedurë e njëjtë është zhvilluar edhe për zyrtaret e tjerë. Po ashtu, gjykata ka administruara si prova dhe dy deklaratat e dëshmitarit të F Z, atë të datës 09.09.2019 dhe 23.09.2019, të cilat deklarata janë përshkruar tek leximi i provave materiale<sup>11</sup>.*

Mbi këto të gjetura, gjykata dëshmitarit F Z respektivisht deklaramit te tij dhënë në shqyrtim gjyqësor nuk i ka dhënë besim të plotë, fillimisht ka qene ne kundërshtim me vetveten për shkak se edhe pse ishte në dijeni se zarfin të cilin ia kishte dorëzuar të akuzuarit S B me paratë të cilat ia kishte dhënë Policia e Kosovës gjatë zbatimit të masave të fshehta- atë të simulimit, i njëjti gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se kishte pasur ftesë për dasmë dhe kur është pyetur nga KTGJ për këtë ndonjë aheng familjar-dasmë në atë kohë, i njëjti ka deklaruar se nuk kishte, dhe kur ishte ballafaquar me CD-në për këtë rrethanë i njëjti kishte deklaruar se nuk kishte për qëllim që ti dorëzonte ftese por kishte për qëllim që ti dorëzonte paratë, dhe se nuk iu është kujtuar. Gjithashtu deklarimi i tij gjate shqyrtimit gjyqësor ka qene thelbësisht në kundërshtim me dy deklaratat e tij dhe atë te datës 09.09.2019 dhe 23.09.2019, dhe po ashtu ka qene ne kundërshtim me bisedën që e ka zhvilluar dëshmitari me të akuzuarin në video incizim, e që gjykata do ti elabroj vetëm disa rrethana që dëshmitari ka rënë në kundërshtim gjatë deklaramit të tij në shqyrtimit gjyqësor ne video incizim. Fillimisht dëshmitari ka deklaruar se nuk e kishte njohur dhe takuar asnjëherë më parë të akuzuarin S B, e që në fakt nga video incizimi përkatësisht biseda e tërësishme ne CD gjatë bisedës në lokal shihet dëgjohet qartë se dëshmitari flet për një takim të mëparshëm që e kishte pasur me të akuzuarin dhe pas ndarjes së tyre tek banka e kishte takuar personin V, i cili e kishte pyetur se ku po e njeh këtë që i folë. Po ashtu, dëshmitari mohon të kishte pasur kontakte para datës 09.09.2019 me të akuzuarin e që në fakt nga biseda që zhvillohet në mes tyre i akuzuari i tregon se ishte në pushim dhe dëshmitari i thotë se njëherë mendova që edhe une të vijë dhe të bashkohem së bashku me ty në pushime. Poashtu, shihet se

<sup>11</sup> Shiqo tek ky aktgjykim, pikën 3.2 provat materiale, 3.2.15 deklarata e dëshmitarit F Z dhënë në polici me date 09.09.2019, dhe 3.2.16 deklarata e dhënë nga dëshmitarit F Z me date 19.09.2019 dhënë në polici.

edhe i akuzuari e kishte të regjistruar numrin e telefonit të dëshmitarit për çka flasin edhe për nxemjen e të akuzuarit në shtëpi që e kishte me peletë, e që i akuzuari i thotë që gjema një njeri që t ia shesë dhe poashtu në atë takim ia dërgon dhe drejtpërsëdrejti fotografitë së kalldajës me peletë. Prandaj këto rrethana dhe rrethana tjera që shihen në bisedë e që janë në kundërshtim me deklaratën e dëshmitarit dhënë në shqyrtim gjyqësor, gjykata ka arritur në përfundim se nuk mund ti falet besimi dëshmisë së dëshmitarit F Z dhënë në shqyrtimin gjyqësor në pjesën ku i ka mohuar faktet që janë përmendur ne video incizim dhe në dy deklaratat e dhënë në polici me datë 09.09.2019 dhe 23.09.2019, për shkak se video incizimi dhe dy deklarata në polici kanë përputhshmëri të njëjtë lidhur me gjendjen e fakteve që janë përmendur në këto deklarata.

Sic është theksuar edhe më lartë nuk është kontestuese fakti fare se i akuzuari S B në mënyrë të drejtpërdrejtë kishte pranuar shumën e parave prej (2000) mijë euro nga dëshmitari F Z të cilat para ishin të Policisë së Kosovës për implementimin e masës së fshehtë simuluese të veprës penale, për çka vërtetohet edhe nga video incizimi i kontrollit ne trup ku tek i akuzuari janë gjetur ne setrën e tij shuma e parave te cilat janë përdorur per zbatimin e masave të fshehta të simulimit ku ne video incizim shihet se te njëjtat mjete sekuestrohen nga i akuzuari dhe numërohen ne prezencën e tij sipas numrave që kishin pasur bankënotat me rastin e vendosjes ne zarfa.

Andaj, mbi këto baza dhe konstatime gjykata ka vërtetuar faktin se në veprimet e të akuzuarit S B, në pikën I të aktgjykimit ekzistojnë dhe formohen të gjitha elementet e veprës penale Marrje e rryshfetit nga neni 421 paragrafi 1 të KPRK-së.

#### 7. Gjendja faktike (Fajësia e të akuzuarit në raport me gjendjen faktike për pikën II të dispozitivit të aktgjykimit

Gjykata, në këtë çështje penale ka vërtetuar gjendjen faktike sikurse në dispozitiv e II-të të të këtij aktgjykimi. Në një përshkrim të shkurtër, ka vërtetuar se i akuzuari nga data e papërcaktuar e deri me datë me datën 19 shtator 2019 në Pejë, në banesën e tij kishte mbajtur në posedim në mënyrë të paautorizuar armën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në kundërshtim me Ligjin për armët.

Fakt i pa kontestushëm ishte se arma i ishte gjetur në banesën e të akuzuarit, ky fakt e ka vërtetuar nga procesverbalit mbi kontrollin e personit dhe shtëpisë, lokaleve dhe pronës me shenjën 2019 KE 372, i datës 19.09.2019, në të cilën konstatohet se në banesën e të akuzuarit S B përkatësisht ne dhomën e tij të fjetjes, është gjetur një revole e tipit “ Zaza Mini” e kalibrit 8 mm, T592372,

e cila është konfiskuar nga policia e Stacionit Policor në Pejë, së bashku me një karikator dhe 10 fishekë të kalibrit 10 mm. Gjykata pa mëdyshje ka vërtetuar faktin se i njëjti e kishte në posedim armën në kundërshtim me ligjin për armën për shkak se nuk kishte pasur leje për mbajtjen në posedim të kësaj arme.

Në nenin 366 paragrafi 1 të KPRK-së, është parashikuar se këtë formë të kësaj veprë penale e kryen : *“Kushdo që mban në pronësi, kontrollon ose posedon armë në shkelje me ligjin e zbatueshëm lidhur me armë të tilla, dënohet me gjobë deri në shtatë mijë e pesëqind (7500) Euro ose me burgim deri në pesë (5) vjet”*. Ndërsa, në Ligjin për armët nr.05/L22, është parashikuar se për të mbajtur në posedim apo pronësi ndonjë armë, duhet që personi të ketë leje valide të lëshuar nga organi kompetent. Pra sipas paragrafit 1 të nenit 366 të KPRK-së, është parashikuar se kjo veprë penale ka disa mënyra alternative të kryerjes dhe atë: *“Mbajtja në pronësi, kontroll, apo posedim pa leje valide”*.

Në këtë drejtim gjykata ka gjetur se PSRK në aktin akuzues kishte pretenduar se i akuzuari kishte mbajtur në pronësi armën e përshkruar si më lartë, e që gjykata nga provat e administruara ka ardhur në përfundim se i njëjti e kishte mbajtur në posedim në mënyrë të paautorizuar armën e cila iu është gjetur në banesën e tij përkatësisht në dhomën e fjetjes për periudhën kohore të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Lidhur me këtë rrethanat sipas propozimit të mbrojtjes gjykata ka dëgjuar dëshmitaren Z Th e cila ishte bashkëshortja e këtu të akuzuarit, e cila gjatë shqyrtimit gjyqësor kishte deklaruar se *“arma ishte e kunatit të saj Samiut - vëllait të akuzuarit S, i cili jeton në Pejë, me familjen e tij dhe se ai ia kishte lënë 2-3 ditë para bastisjes, ngase ishte duke shkuar në Rozhajë, dhe kishte ardhur tek banesa e të akuzuarit S dhe se në banesë ishte vetëm dëshmitarja Z dhe se S i kishte thënë se po ta lë këtë armë se jam duke shkruar në Rozhajë dhe do të vinte ta merrte atë ditë apo të nesërmen dhe se për këtë gjë nuk i kishte treguar askujt që kunati i saj i kishte lënë armën në shtëpi, pasi që ia kishte lënë në besë dhe ai i kishte kërkuar ashtu, madje shton se as bashkëshorti i saj S nuk ishte në dijeni për këtë fakt. Ajo ka shtuar se nuk e kishte ditur nëse arma ishte me leje apo jo. Tutje ka shtuar se me S nuk ka biseduar ndonjëherë në lidhje me armët dhe në pyetjen e gjykatës së “ meqë po thuani që edhe për paratë edhe armën që nuk e ka ditur S dhe meqë ka qenë gjyqtar, a i keni mbajtur çdo here kësi fshehtësi S, pse vendose me lënë paratë në dhomën e V e armën në dhomën e juaj të S”, dëshmitarja Z Th nuk ka dashur që të përgjigjet”. Gjykata dëshminë e kësaj dëshmitarje e vlerësoj si pjesërisht të besueshme vetëm kur është deklaruar për paratë e gjetura, ndërsa për armën e vlerësoj si të pabesueshme për shkak se deklarim i saj*

bëhet me qëllim të mbrojtjes së bashkëshortit të saj për veprën penale për të cilën ngarkohet dhe po ashtu deklarimi i saj është në kundërshtim edhe me deklaratën e të akuzuarit S B të dhënë në polici të cilën deklaratë e kishte dhënë në prezencën e mbrojtësit të tij av. Gezim Kollçaku, për shkak dëshmitarja e përmend faktin se i akuzuari S B nuk ishte në dijeni për paratë që ishin gjetur në banesën e tyre gjatë bastisjes dhe për armën të cilën kinse ia kishte lënë kunati i saj-Samiu, dhe për këto fakte gjegjësisht këto gjëra nuk i kishte treguar të akuzuarit edhe pse e kishte bashkëshort, mirëpo i akuzuari S B gjatë dhënies së deklaratës në polici me datën 20.09.2019, në pytjen e oficerit policor “*gjatë bastisjes së zhvilluar me datë 19.09.2019, kemi hasur në një shumë të parave prej 10.000.00 euro dhe një pistoletë, çka mund të na thoni për këtë të kujt janë këto para dhe ajo pistoletë*”, i akuzuari ishte përgjigjur “Paratë me sa e di unë janë të motrës së gruas sime e cila punon dhe jeton në Gjermani me familje, ndërsa lidhur me pistoletën nuk është e imja por kush është pronar nuk mund të deklarohem për momentin”, pra vet i akuzuari e pranon se kishte dijeni edhe për paratë dhe për armën ku për paratë thekson saktësisht së kujt i kishit takuar, ndërsa për armën ka dijeni për pronësinë e saj mirëpo që nuk ishte deklaruar lidhur me atë rrethanë. Po ashtu deklarata e dëshmitares Z Th, se vëllau i të akuzuarit-kunati S e kishte lënë në banesën e tyre armën për shkak të udhëtimit për në Rozhajë, ky deklaram është në kundërshtim edhe me shkresën e Sistemit të Menaxhimit të Kufirit, e datës 08.11.2022, për kalimin kufitar të personit S B, për periudhën 01.01.2019 - 09.11.2022, ora 08:03 minuta, ku gjykata nga kjo shkresë ka vërtetuar faktin se personi Sami Berisha- vëllai i të akuzuarit S B, sipas Sistemit për Menaxhimin e Kufirit –SMK, gjatë periudhës kohore të lartshënuar nuk kishte pasur asnjë Hyrje-Dalje në kalimet kufitare gjatë kësaj periudhe kohore prej me shumë se 3 viteve, përkatësisht as nga pika kufitare në Rozhajë siç kishte deklaruar dhe dëshmitarja, prandaj dhe deklaramin e saj gjykata e vlerësoj si jo të besueshme në pjesën kur është deklaruar lidhur me armën.

Gjykata në këtë drejtim ka vërtetuar faktin se i akuzuari S B ishte në dijeni lidhur me armën të cilën e kishte në banesën e tij si pronar i banesës, e që vërtetohet na bazë të raportit të bastisjes. Në këtë drejtim gjykata vlerëson se në rastin konkret, me posedim të armës në kuptim të nenit 366 par.1 i KPRK-së kuptohet çdo rast kur një person i caktuar ndodhet në posedim faktik të armës, për të cilën nuk kishte leje për mbajtje e armës nga organi kompetent, dhe kjo shprehje duhet kuptuar si një raport i tillë i kryesit ndaj armës nga i cili manifestohet raporti i caktuar i pushtetit të kryesit ndaj një objekti të tillë përkatësisht ai atë objekt (armën) duhet ta mbajë si të tijen<sup>12</sup>. Pra, në rastin konkret i akuzuari nuk ka pasur sjellje si pronar të armës, pasi që në rastin

<sup>12</sup> Dr. Ismet Salihu, Hilmi Zhitia dhe Fejzulla Hasani, Komentari i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Botimi 1, fq.1039.

konkret gjykata nuk ka vërtetuar faktin se i akuzuari e kishte në pronësi armën mirëpo gjatë shqyrtimit gjyqësor me provat e administruara gjykata ka vërtetuar faktin se i akuzuari S Be kishte mbajtur në posedim armën pa lejen e organit kompetent për periudhën e përshkruar kohore si në dispozitivin e II të aktgjykimit dhe kjo është vërtetuar duke u bazuar në atë se armën e kishte mbajtur në banesën e tij dhe e njëjta armë ishte gjetur në dhomën e tij dhe se i akuzuari ishte në dijeni për posedimin e kësaj armë. Andaj, gjykata ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit konsumohen elementet e veprës penale nga neni 366 par.1 i KPRK-së.

#### 8. Pretendimet e palëve

Përveç pretendimeve të mbrojtjes që janë elaboruar më lartë me rastin e vlerësimit të provave, mbrojtja në fjalën përfundimtare të dhënë me shkrim ka dhënë edhe pretendime tjera si në vijim:

Sipas pretendimeve të mbrojtjes provat që janë nxjerrur gjatë fazës së hetimeve janë të kundërligjshme, përkatësisht duke specifikuar CD-në e datës 19.09.2019, video incizimin, CD-ne me videoincizim ne trup, videon e kontrollit ne trup dhe raportin e vëzhgimit te datës 19.09.2019, duke kundërshtuar se këto prova janë nxjerrur sipas urdhërësave te kundërligjshme te gjykatës dhe po ashtu ka kundërshtuar kundërligjshmërinë e procesverbalit e personit dhe shtëpisë se lokaleve dhe pronës, fotodokumentacioni nga vendi i bastisjes te dyja te datës 19.09.2019 dhe listën e armeve dhe municioneve te te njëjtës datë si dhe pretendimet tjera rreth zhvillimi te hetimit te veprës penale te korrupsionit që tani është ngritur aktakuzës për Marrje të ryshfetit, sipas vlerësimit te gjykatës lidhur me këto pretendime mbrojtja edhe gjate fazës se kundërshtimit te provave dhe kërkesës për hedhjen e aktakuzës i kishte kundërshtuar provat të cilat ishin cekur ne aktakuzë me pretendime te njëjta, dhe po ashtu e kishte kundërshtuar edhe aktakuzën me pretendime te njëjta. Prandaj, gjykata këto pretendime i vlerëson si te pabazuara sepse gjykata kishte dhënë arsye te veçanta ne aktvendimin lidhur me refuzimin e kërkesës për hedhjen e aktakuzës dhe kundërshtimin e provave, dhe për secilin pretendim te mbrojtjes dhe secilën prove kishte dhënë arsye te veçante, ashtu që kundër të njëjti aktvendim me te njëjtat pretendime mbrojtja kishte parashtruar ankese, e cila ankesë ishte refuzuar nga Gjykata e Apelit e Kosovës si e pabazuar. Prandaj, gjykata konsideron se pretendimet e mbrojtjes te paraqitura në fjalën përfundimtare janë të njëjta dhe të ngjashme prandaj edhe nuk do të lëshohet ne elaborimin e mëtejme te tyre, për shkak se janë shterur dhe janë dhënë arsyet te mjaftueshme ne fazën e kundërshtimit te provave, gjegjësisht ne aktvendimin lidhur me kërkesën për hedhjen e aktakuzës dhe kundërshtimin e provave.



Mbrojtja, gjithashtu pretendon se dëshmitari F Z ishte nxitur me rastin e simulimit të veprës penale për të kryer veprën penale S B, ku mbrojtja gjatë fjalës përfundimtare i përmend dhe disa praktika të GJEDNJ-së lidhur me provokimin-nxitjen, mirëpo gjykata në këtë drejtim konsideron se ky pretendim i mbrojtjes është i pabazuar për shkak se duke marrë për bazë se i akuzuari S B si person zyrtar përkatësisht gjyqtar- i Departamentit të Krimeve të Rënda në Gjykatën Themelore në Pejë, i njëjti për nga kategorizimi i personave zyrtar karakterizohet si person i profilit të lartë zyrtar dhe i njëjti po ashtu kishte për kompetencë për të gjykuar edhe veprat penale për të cilat vet tani ngarkohet, për çka edhe kishte të dhënë dhe Kodin e Etikës Profesionale për sjellje si gjyqtar, ku njëri prej kriterëve që flitet për integritetin e gjyqtarit, është edhe së *“gjyqtari dhe anëtarët e familjes se tij të ngushtë nuk mund të kërkojnë as të pranojnë dhurata, testament, hua apo shërbime tjera për veprim ose mosveprim përgjatë ushtrimit të funksionit gjyqësor, gjithashtu me vetëdije nuk lejon personelit gjyqësor apo të tjerëve të cilët janë nën mbikëqyrje të tij”*, pra i akuzuari ishte i vetëdijshëm në çdo rrethë se pranimi i çfarëdo dhurate ishte i ndaluar. Duke marrë për bazë bisedën e cila zhvillohet në video incizim në mes të dëshmitarit F Z dhe të akuzuarit S B, dëshmitari i përmend dhuratën, shumën e dhuratës, vendin se ku i kishte lënë, rrezikun pse nuk i kishte sjellë në lokal për shkak se mos po e shihej nga ndokush dhe rastin e vëllait të tij se e kishin kryer punën, në këtë rrethë vet i akuzuari shkon në veturën e tij e pranon dhuratën që e përmend në lokal dhe në fund dhe e falënderon. Gjykata në këtë rast vlerëson se nuk kemi të bëjmë me nxitje apo provokim nga ana e dëshmitarit F Z, mirëpo në rastin konkret i akuzuari kishte vepruar me dashje dhe vetëdije të plote, pra ishte në dijeni se për çka dhe përse po e pranon këtë dhuratë nga i dëshmitari.

Gjithashtu, mbrojtja pretendon se nuk është provuar lidhja kauzale midis pranimi të shumës prej 2.000 euro me veprimin në kundërshtim me detyrën zyrtare si piken I të dispozitivit të aktakuzës, për shkak se mjetet në shumë prej 2 mijë euro janë pranuar me datën 19.09.2019, pra tre vjet e gjysme nga aktgjykimi PRKP.nr.46/15, kur është bërë i formës së prerë ndaj edhe në rastin konkret mungon lidhja shkakësore midis veprimit dhe pasojës, sepse veprimi i pranimi të shumës nuk ka lidhje me aktgjykimin i cili ishte nxjerrur tri vjet e gjysmë më parë. Lidhur me këtë pretendim të mbrojtjes, fillimisht gjykata sqaron se sa i përket se i njëjti kishte vepruar në kundërshtim me detyrën e tij zyrtare nga ana e gjykatës nuk ka mundur të vërtetohet se i akuzuari kishte vepruar në kundërshtim me detyrën e tij zyrtare për çka edhe ka bërë ri cilësimin e veprës penale. Ndërsa sa i përket çështjes se mungon lidhja shkakësore midis veprimit të të akuzuarit dhe pranimi të dhuratës, ky pretendim është i pabazuar për shkak se pamëdyshje është vërtetuar nga video incizimi se e gjithë biseda zhvillohet për rastin që vëllau i dëshmitarit e kishte pranuar

fajësinë në rastin ku e kishte gjykuar i akuzuari dhe se vellau i dëshmitarit kishte frikë për aktgjykimin që do të nxirrte i akuzuari si gjyqtar e që e është elaboruar në gjetjet e gjykatës lidhur me fajësinë e të akuzuarit, për çka i akuzuari e kishte pranuar dhuratën në vlerë prej 2 mije euro për vete dhe për personin e ashtuquajtur “Daja”. Andaj, dhe sa i përket elementit të kohës se kishin kaluar tri vite e gjysmë nga plotfuqishmëria e vendimi kur i akuzuari kishte pranuar dhuratën, gjykata vlerëson se edhe në këtë rast konsumohen elementet e veprës penale pavarësisht periudhës kohore, pra kur personi kishte kërkuar më parë rryshfet dhe pas një kohë e merr rryshfetin, gjykata konsideron se me pranimin e rryshfetit-dhuratës edhe konsumohen e veprës penale për shkak se në këtë drejtim gjykata vlerëson se është vërtetuar se i akuzuari gjatë kryerjes së veprimit të tij zyrtar ishte i motivuar nga një dhuratë e tillë dhe lidhja shkakësore ndërmjet dhuratës dhe veprimit të të akuzuarit është vërtetuar.

#### 9. Propozimet e mbrojtjes të bëra gjatë shqyrtimit.

Mbrojtja gjatë shqyrtimit gjyqësor ka propozuar që në cilësi të dëshmitareve të dëgjohet sërish dëshmitari F Z, për shkak se ishte bërë ndryshimi i trupit gjykues përkatësisht anëtari i trupit gjykues, po ashtu ka propozuar që të dëgjohen në cilësi të dëshmitarëve S B, V D H, V K, M M, S B të cilat propozime gjykata i ka refuzuar për arsye si në vijim:

- Sa i përket dëgjimit të sërishëm të dëshmitarit F Z për shkak të ndryshimit të trupit gjykues, gjykata këtë propozim e ka refuzuar me arsyetimin se : nuk ishte e nevojshme dëgjimi i *sërish në shqyrtim gjyqësor i dëshmitarit Florim Zeka, për shkak se edhe vet mbrojtësi gjatë arsyetimit të tij kishte theksuar se nuk kishte ndonjë arsyeje apo fakt që ky dëshmitar të ftohet që do të thotë diçka tjetër prej asaj që e ka thënë në shqyrtimet gjyqësore, por vetëm për faktin se nuk ishte dëgjuar nga ana e anëtarit të ri të trupit gjykues. Andaj, trupi gjykues këtë pretendim e ka vlerësuar si të pabazuar për se ekzaminimi i këtij dëshmitari ishte bërë nga ana e gjitha palëve me parashtrimin e pyetjeve nga gjitha palët dhe trupi gjykues, kryetari i trupit gjykues dhe anëtari tjetër i trupit gjykues është i njëjti dhe po ashtu sipas nenit 311 par.1 të KPP-së thuhet se trupi gjykues pas dëgjimit të palëve “mund të vendosë që dëshmitarët dhe ekspertet të mos merren sërish në pyetje, të mos bëhet këqyrja e vendit por të lexohen deklaratimet e dëshmitarëve të dhëna në shqyrtimet e mëparshme gjyqësore, apo të bëhet këqyrja e vendit”, andaj trupi gjykues e kishte vlerësuar se kjo dispozite është në diskrecion të gjykatës, e që gjykata e sheh të pa arsyeshëm dhe si zvarritje të procedurës dëgjimin e sërishëm të dëshmitarit i cili është marrë në pyetje gjatë 3 seancave të shqyrtimit gjyqësor, dhe meqenëse edhe vet mbrojtja nuk ka cekur ndonjë fakt konkret lidhur me dëshminë e tij që do të ndryshonte në aspektin e të provuarit*

*nga ky dëshmitarë.”* Dhe gjithashtu anëtari i ri i trupit gjykues ishte njoftuar me gjithë përmbajtjen e deklaratës se dhënë nga dëshmitari F Z në shqyrtimin gjyqësor para angazhimit të tij, përkatësisht seancës që do të paraqites si anëtar i trupit gjykues dhe për rrethanat që kishe paraqitur mbrojtja kishe deklaruar se dëgjimi i serishëm ishte i pa nevojshëm.

- Sa i përket propozimit të mbrojtjes për dëgjimin e dëshmitarit S B, se i njëjti nuk ishte në trupin gjykues kur ishte vendosur për çështjen e M Z, të vërtetohet se a kishte kërkuar shumen prej 4000 mijë euro nga F Z dhe rrethanat tjera të paraqitura nga mbrojtja, gjykata këtë propozim e ka refuzuar si të pabazuar dy (2) herë me arsyetimin se:” sa i përket marrjes së ryshfetit në vlerë prej 4 mijë euro për periudhën që pretendon mbrojtja, gjykata kishte konstatuar se për rastin e dëshmitarit të propozuar S B përsërit se për këtë çështje ka pasur një hetim edhe ndaj këtij dëshmitari dhe është pushuar hetimi me aktvendim të PSRK-së, prandaj gjykata e ka konsideruar se është i pa nevojshëm dëgjimi i tij në shqyrtimin gjyqësor lidhur me sqarimin e rrethanave për veprën penale për të cilën vet ishte i dyshuar dhe ishte zhvilluar një hetim ndaj S B, dhe i cili hetim kishte pushuar sipas vendimit të PSRK-se. Për më tepër kjo gjykatë sqaron se tani kohën kur është shpallur edhe aktgjykimi ky dëshmitar i propozuar nga mbrojtja sipas nenit 123 të KPPRK-së, hyn tek kategoria e dëshmitarëve të privilegjuar në të cilën në paragrafin 1 të këtij neni përcaktohet se : *“Si dëshmitar nuk mund të merret në pyetje: nenpar.1.3 përcakton.. i bashkëpandehuri derisa zbatohet procedurë e përbashkët apo e veçuar përveç kur i bashkëpandehuri është dëshmitar bashkëpunues sipas nenit 231 të KPP-së.* Poashtu, sa i përket rrethanës të se me dëgjimin e tij duhej të kuptohet afërsia e dëshmitarit S B me dëshmitarin F Z, gjykata e kishte konsideruar se kjo rrethanë është sqaruar nga vet dëshmitari F Z, i cili në procesverbalin e datës 17.11.2021, në shqyrtimin gjyqësor kishte theksuar se S B e ka njohur si gjyqtar dhe si “dajë” e ka thirr ngase ai ka qenë i fshatit Vrellë, prej nga i ka dajtë edhe ai, dhe nga kjo rrjedh se nuk ka pasur ndonjë afërsi gjaku.

- Sa i përket propozimit të mbrojtjes për dëgjimin e dëshmitares V H, gjykata e kishte refuzuar këtë propozim me arsyetimin se dëgjimi i kësaj dëshmitarja ishte i panevojshëm për shkak se ishte jashtë objektit të akuzës, i akuzuari akuzohet se kishte marrë ryshfet në shumë prej 2000 mijë euro në shtator të vitit 2019, dhe fakti se nuk kishte parashtruar ankesë në vitin 2015 në cilësi të prokurorës dëshmitarja e propozuar, kjo për gjykatën nuk ishte kontestuese dhe kishte vlerësuar se ishte në diskrecion të prokurorisë, përkatësisht të prokurorit të çështjes dhe kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Pejë, në rastet përkatësisht vendimet që janë përmendur në këtë rast. Prandaj, gjykata ka vlerësuar se dëgjimi i kësaj dëshmitarja ka vlerësuar

se nuk do të vertetone asgjë përvec faktit se nuk kishte parashtruar ankesë, që për gjykatën nuk ishte kontestuese.

- Sa i përket propozimit të mbrojtjes për dëgjimin e dëshmitarit S B gjykata kete propozim e kishte refuzuar si të pabazuar me arsyetimin se do ta vlerësoj deklaratën e dëshmitares Z Th ne raport me provat e tjera dhe se duke marrë afërsinë e dëshmitarit me të akuzuarin që ishin vëllezer.

- Po ashtu, sa i përket propozimit të mbrojtjes për dëgjimin e dëshmitarit V K, gjykata kete propozim të mbrojtjes e ka refuzuar me arsyetimin se *“është jashtë objektit të akuzës se dëshmitari V a e ka pasur rolin e bashkëpunëtorit në raport me deklarin e Florim Zekës ne të cilën mbrojtja pretendonte se kishte thënë se kam njohuri që ky gjyqtar asnjë lende nuk e kryen pa para pasi që gjyqtari S B ka kërkuar që të hyj si ndërmjetësues ne një rast ku M M ishte si i dyshuar dhe ma ka dërguar bashkëpunëtorin e tij V. Andaj, gjykata mes tjerash ka ardhur ne përfundim se kredibilitetin i dëshmitarit F Z do të vlerësohet me rastin e vlerësimit të deklaratës së tij ne raport me të gjitha provat tjera që janë administruar në shqyrtimin gjyqësor dhe dëgjimi i dëshmitarit të propozuar ka qenë i panevojshme dhe jashtë objektit të çështjes ne rastin konkret.”*

- Gjithashtu, gjykata ka refuzuar dhe propozimin që si prova të administrohen faturat përkatësisht dëftesat për tërheqjen e parave nga dëshmitarja T Th, me arsyetimin se të njëjtat ishin sjellë nga ana e mbrojtjes ne gjuhen gjermane, dhe përkundër faktit që gjykata kishte obliguar mbrojtjen që ti përkthente me qëllim që të konstatohej përmbajtja e tyre, dhe pastaj të administroheshin si prova, dhe mos përmbushja e këtij obligimi nga ana e mbrojtjes gjykata ka vlerësuar se nuk mund të administrohen për shkak se nuk janë sjellur ne gjuhen zyrtare me të cilën është procedura kjo çështje.

#### 10. Gjendjet faktike të vërtetuara

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë gjykata ka vërtetuar këto gjendje faktike:

- se i akuzuari S B, me dashje ka kryer veprën penale: Marrje e ryshfetit nga neni 421 par.1 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin I, të këtij Aktgjykimi.

- se i akuzuari S B, me dashje ka kryer veprën penale: Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin II, të këtij Aktgjykimi.

### 11. Elementet e veprave penale

- Në nenin 421 paragrafi 1 të KPRK-së, është parashikuar se formën themelore të veprës penale marrje e ryshfetit e kryen: *“Personi zyrtar ose personi i huaj zyrtar apo zyrtari publik i huaj i cili në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, kërkon ose pranon ndonjë dhuratë apo përfitim tjetër për vete apo personin tjetër, ose që pranon ofertën apo premtimin për dhuratë apo përfitim të tillë, në mënyrë që personi zyrtar ose personi i huaj zyrtar apo zyrtari publik i huaj të veprojë ose të mos veprojë në pajtim me detyrën e tij zyrtare, dënohet me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet”.*

- Në nenin 366 paragrafi 1 të KPRK-së, është parashikuar se formën themelore të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve e kryen: *“Kushdo që mban në pronësi, kontrollon ose posedon armë në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armë të tilla, dënohet me gjobë deri në shtatë mijë e pesëqind (7.500) Euro ose me burgim deri në pesë (5) vjet”*

### 12. Vendimet e trupit gjykues

Duke u bazuar në këto që janë cekur me lartë dhe në nenin 364 par.1 dhe 2 të KPP-së, trupit gjykues që të akuzuarin S B, e ka shpallur fajtor për veprat penale për të cilat është ngarkuar me aktakuzë, të ri-cilsuar në pikën I nga ana gjykatës, ngase në veprimet e të akuzuarit të përshkruara në pikën I të aktgjykimit formohen të gjitha elementet e veprës penale: marrje e ryshfetit nga neni 421 paragrafi 1 të KPRK-së, ndërsa edhe për pikën II të aktgjykimit formohen të gjitha elementet e veprës penale: mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1 të KPRK-së dhe për këtë kanë vendosur që të akuzuarin ta gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

### 13. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të akuzuarit me rastin e matjes së dënimit, gjykata i ka marrë për bazë disa rrethana rënduese dhe lehtësuese.

Si rrethana rënduese për të akuzuarin S B, gjykata i ka marrë për bazë këto rrethana: shkallën e përgjegjësisë penale që i akuzuari ka qenë përgjegjës i nivelit të lartë zyrtar-gjegjësisht i njëjti ka qenë Gjyqtar në Gjykatën Themelore në Pejë, ku i akuzuari është mirë i edukuar - me përgatitje profesionale dhe i njëjti do të duhej të sillej me integritet të lartë si në aspektin profesional ashtu dhe në jetën e tij personale, e aq më shumë kur i njëjti me përvojë e tij e ka ditur fare mirë se marrja e ryshfetit është vepër penale të cilat vepra i kishte në kompetencë për ti gjykuar dhe vet ai, mirëpo përkundër kësaj i njëjti kishte marr vendim në pajtim me detyrën zyrtar dhe për çka për këtë vendim kishte pranuar dhuratën nga dëshmitari.

Si gjyqtar ka qenë i thirrur të vendos drejtësi, qytetarët kanë pritur nga i njëjti vendosjen e drejtësisë në gjykatën ku ka shërbyer, ndërsa në të kundërtën jo vetëm që e ka humbur imazhin e institucionit ku ka shërbyer, por dhe gjithë institucionit të drejtësisë. Pra veprimi i tij jo vetëm që kishte efekt negativ për të si gjyqtar, (nji detyrë e shenjtë e besuar nga qytetarët tek ai), por e kishte efektin negativ edhe në gjithë besimin ndaj sistemit të drejtësisë. Prandaj, gjykata këtë e ka vlerësuar si rrethanë rënduese.

Ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata i ka marrë për bazë këto: faktin se sjella e tij gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësore ka qenë e mirë ka pasur qëndrim tejet korrekt, si dhe faktin se më parë nuk ka qenë i dënuar për ndonjë vepër tjetër penale.

Prandaj duke marrë për bazë të lartpërmendurat gjykata ardhur në përfundim se me dënimet e shqiptuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, do të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimit nga neni 38 i KPRK-së dhe këto dënime si të tilla të shqiptuara sipas bindjes së gjykatës janë në proporcion me veprat penale të kryera dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari dhe se dënimet e shqiptuara do të ndikojnë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjnë rehabilitimin e tij, do të parandalojnë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe do të shprehin gjykimin shoqëror për veprat penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

#### 14. Vendimi mbi shqiptimin e dënimit plotësues

Duke u bazuar në nenin 59 par.1 dhe par.2 nënpar.2.3 dhe nenin 62 par.1 dhe nënpar.4.1 të KPRK-së, përveç dënimit me burgim ndaj të akuzuarit S B, është shqiptuar edhe dënimi plotësues ndalimi i ushtrimit i funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik në kohëzgjatje prej dy (3) vite, pas mbajtjes së dënimit me burgim të shqiptuar si në këtë aktgjykim. Ky dënim plotësues i është shqiptuar të akuzuarit për faktin se i njëjti ka keqpërdorur detyrën zyrtare – ashtu që duke nxjerr vendime në pajtim me detyrën e tij zyrtare ka marrur rryshfet që nënkupton se ka shfrytëzuar pozicionin e tij si Gjyqtar në Departamentin e Krimeve të Rënda të Gjykatës Themelore në Pejë duke pranuar kundërligjshëm dhe drejtëpërdrejtë dhuratë për punën përkatësisht veprimet e tij që i kishte si detyrë zyrtare, andaj gjykata ka ardhur në përfundim se janë plotësuar kushtet për shqiptimin e dënimit plotësues duke marrë për bazë dispozitat e lartpërmendura.

#### 15. Vendimi mbi konfiskimin e armës

Duke u bazuar në nenin 366 par.3 të KPRK-së, si dhe në nenin 276 par.2 nënpar.2.1 të KPP-së, gjykata ka vendosur që ndaj të akuzuarit S B të konfiskohet arma dhe municioni si në dispozitiv të këtij aktgjykimi si objekt i veprës penale.

#### 16. Vendimi lidhur me kthimin e mjeteve të sekuestruara

Duke u bazuar në nenin 113 të KPP-së, gjykata ka vendosur që të bëjë kthimin e mjeteve për shkak se nuk kishte bazë për konfiskimin e tyre, e që edhe sipas dispozitës së lartpërmendur përcaktohet se: “Përveç siç parashihet në nenin 276 të këtij Kodi, provat apo pasuria e specifikuar të sekuestruara përkohësisht apo ndaluara gjatë procedurës penale i kthehen pronarit ose poseduesit kur procedura pushohet ose kur nuk ka bazë për sekuestrimin e përkohshëm apo konfiskimin e tyre”, ashtu që deri tek marrja e vendimit për kthimin e tyre gjykata ka administruara e mëposhtme e të cilat do ti elaboroj si në vijim:

Lidhur me kthimin e mjeteve në vlerë prej 10.000.00 Euro te cilat ishin sekuestruara nga ana e të akuzuarit gjatë bastisjes se banesës se tij me datë 19.09.2019, gjykata ka vërtetuar faktin se nuk kishte bazë ligjore për konfiskimin e tyre, përkatësisht nuk ishte vërtetuar me asnjë prove se të njëjtat janë përfituar me vepër penale. Gjykata deri tek ky konstatim ka ardhur dëgjimi i dëshmitares T Th, Zy Th, V Sh, por edhe nga fotografitë që janë bërë me rastin e bastisjes e që janë bashkangjitur raportit të këqyrjes se vendit të ngjarjes. Dëshmitarja T Th gjatë deklaramentit

në shqyrtimin gjyqësor kishte deklaruar:” *se deklararon se ato para janë të saj dhe se ia kishte lënë motrës së saj kur kishte ardhur në pushime verës në muajin Gusht, me qëllim që deri në pushimin tjetër që e kishte pasur në Nëntor, t’i paguante mjeshtrit që kishin pasur me rregulluar murin e shtëpisë më rrethoja (tela) dhe për të rregulluar një pjesë të ballkonit*”. Gjykata këtë deklaram të kësaj dëshmitarja e mori si te besueshme për shkak se i njëjti deklaram është në harmoni dhe me deklaramin e dëshmitarëve Z Th dhe V Sh dhe poashtu fotodokumentacionin e shkresave te lendes. Edhe dëshmitarja Z Th gjatë dëshmisë së saj kishte deklaruar se :”*Paratë që janë gjendur ne banesën e saj me datën 19.09.2019, gjatë bastisjes, kanë qenë të motrës së saj T, të cilat kanë qenë të vendosura në një zarf, e cila në prezencën e motrës së saj në zarf ka shënuar emrin T Th. Paratë atë ditë që janë sekuestruar ka deklaruar se kanë qenë në dhomën e V - djalit të saj dhe kanë qenë të ndara në dy vende nga 5000 Euro dhe të gjitha kanë qenë nga 50 Euro*”. Në këtë drejtim edhe dëshmitari V Sh, si hetues i këtij rasti gjatë kohës sa ishte në bastisjes, gjatë shqyrtimit gjyqësor ne cilësine e dëshmitarit ka deklaruar se kishte dëgjuar komunikime te familjareve te te akuzuarit se këto para ishin te dikujt tjetër por saktësisht nuk me kujtohet se per kënd behej fjale. Poashtu nga fotodokumentacioni përkatësisht ne dy zarfat që shihen ne dokumentacion ne foton me numër 23, shihen dy mbështjellës me mbishkrimin T Th. Prandaj, gjykata ka ardhur ne përfundim se pamedyshje këto para kane qene te personit T Th dhe PSRK nuk ka arritur te vërtetoj faktin se kishte baze per konfiskimin e tyre, përkatësisht që ishin përfituar me vepër penale nga ana e te akuzuarit, prandaj dhe gjykata ka bërë kthimin e këtyre mjeteve duke e obliguar Agjencine per Sekuestrimin e pasurisë se Konfiskuar të Pasurisë që pas plotfuqishmërisë të njëjtat tia dorëzoj te akuzuarit.

#### 17. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Duke e pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe duke u bazuar në nenin 450 par.1 dhe nenin 452 të KPP-së, si dhe duke u bazuar në nenin 39 par.3 nënpar.3.3 të Ligjit Nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit, gjykata ka vendosur që i akuzuari pas plotëfuqishmërisë së aktgjykimit, t’i paguaj shpenzimet e paushallit gjyqësor si dhe shpenzimet për programin për kompensimin e viktimave të krimit, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për pjesën gjykuese konform nenit 364 të KPP-së.



**- DEPARTAMENTI SPECIAL -**  
**PS.nr.10/20, me datë 28.04.2023**

**Zyrtarja Ligjore,**  
**Mirjetë Demiri**

**Kryetari i trupit gjykues,**  
**Mentor Bajraktari**

**UDHËZIMI JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej tridhjetë (30) ditëve, pas marrjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.